

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“AUDITIM FINANCIAR DHE  
PËRPUTHSHMËRIE NË BASHKINË  
DROPULL”**

**TIRANË, SHTATOR 2019**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

| <b>NR.</b>   | <b>PERMBAJTJA</b>   | <b>FAQE</b> |
|--------------|---|-------------|
| <b>I</b>     | <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>   | 04-10       |
| <b>I/c</b>   | <b>OPINIONI I AUDITIMIT</b>   | 10-13       |
| <b>II</b>    | <b>HYRJA</b>  | 14-18       |
| <b>III</b>   | <b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>   | 19-55       |
|              | <i>Informacioni i Përgjithshëm.</i>   | 19-20       |
| <b>IV</b>    | <b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>   | 21-63       |
| <b>A/1/2</b> | <i>Mbi vlerësimin e riskut.</i>   | 21-23       |
| <b>A/3</b>   | <i>Kontrolli i brendshëm</i>  | 23-26       |
| <b>B</b>     | <i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit</i>   | 26-32       |
| <b>C</b>     | <i>Vlerësimi i raportimit financiar, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>   | 32-43       |
| <b>D</b>     | <i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.</i> | 43-47       |
| <b>D/4</b>   | <i>Auditim për zbatimin e punimeve</i>  | 47-54       |
| <b>E</b>     | <i>Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.</i>  | 54-55       |
|              | <b>REKOMANDIME:</b>   | 55-63       |



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

### SHKURTIME.

|                |   |
|----------------|---|
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit.  |
| <b>MFK</b>     | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.  |
| <b>NA</b>      | Nëpunës Autorizues.   |
| <b>NZ</b>      | Nëpunës Zbatues.  |
| <b>GSM</b>     | Grupi i Menaxhimit Strategjik.  |
| <b>NJAB</b>    | Njësia e Auditimit të Brendshëm.  |
| <b>AB</b>      | Auditi i Brendshëm  |
| <b>MAB</b>     | Manuali i Auditimit të Brendshëm.   |
| <b>FZHR</b>    | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve  |
| <b>AQT</b>     | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.  |
| <b>UMF</b>     | Udhëzim i Ministrisë së Financave   |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave.   |
| <b>VKB</b>     | Vendim i Këshillit Bashkiak.  |
| <b>ISSAI</b>   | Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.                        |
| <b>INOTSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.                         |
| <b>ISA</b>     | Standartet Ndërkombëtare të Auditimit   |
| <b>IFAC</b>    | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve   |
| <b>IPSAS</b>   | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik                          |
| <b>ALUIZNI</b> | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale. |
| <b>IT</b>      | Teknologjia e Informacionit.  |
| <b>NJA</b>     | Njësi Administrative.   |
| <b>SHA</b>     | Shoqëri Anonimë.  |
| <b>BOE</b>     | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.  |
| <b>OE</b>      | Operator Ekonomik.  |



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**1.a.** Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Dropull dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar 65 transaksione financiare nga data bazë e thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230- 231 “investime, si dhe 16 procedura prokurimi, me vlerë 70% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi.

### I.b. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE.

| Gjetja | Përmbledhje e gjetjes   | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi   |
|--------|---|---------------------|----------|---|
| 1      | Bashkia Dropull, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave                   | 23-24 dhe Aneks A   | E lartë  | Bashkia Dropull të marrë masa, të dërgojë në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse. |
| 2      | NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj nuk është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve.  | 24-26 dhe Aneks A   | I mesëm. | Nga Bashkia Dropull të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të kryejë monitorimi e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.   |
| 3      | Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2018, Bashkia Dropull ka një detyrim ndaj të tretëve prej 2,030,698 lekë (llogaria 486, furnitor e llogari të lidhura me to).  | 32 – 33 dhe Aneks B | I mesëm  | Nuk ka rekomandim pasi këto fatura janë likuiduar në 6 mujorin e parë të vitit 2019   |
| 4      | Bashkia Dropull ka administruar 4 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerën <b>5,012,862 lekë</b> , efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. | 33- 34 dhe Aneks B  | I mesëm  | Nuk ka rekomandim pasi këto shuma janë likuiduar në 6 mujorin e parë të vitit 2019  |
| 5      | Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të   | 31 - 32 dhe Aneks B | E lartë  | Sektori i Taksave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa   |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

|   |   |                     |         |   |
|---|---|---------------------|---------|---|
|   | <p>periudhës janë gjithsej debitorë 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, <b>në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë</b> (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë).</p>   |                     |         | <p>arkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, <b>në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë</b> (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë), bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime</p> |
| 6 | <p>Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “<i>Studime e projekte</i>”, në bilancin e vitit 2018 paraqitet në vlerën 6,263,032 lekë, ose rritur për vlerën 2,289,278 lekë. Sipas analizës rezultoi se në Bashkinë Dropull në 31.12.2018 llogaria 202 paraqet 18 studime dhe kërtime nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a. <i>Gjate vitit 2017 janë shtuar 3 studime me vlerën prej 2,339,280 lekë.</i></li><li>b. <i>Gjatë vitit 2018 janë shtuar 4 studime me vlerën prej 3,394,519 lekë.</i></li></ul> <p>Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se 28 studime e projekte në vlerën <b>11,688,221</b> lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish Komunitet të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Dropull. Referuar të dhënave të subjektit, ku të gjithë projektet janë vënë në zbatim, kontabilizimi i këtyre vlerave në llog. 202 është i gabuar, pasi vlera e këtyre projekteve duhet të paraqitet në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas objekteve), pasi përfaqëson vlerën e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar</p> | 34 – 35 dhe Aneks C | I mesëm | <p>Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “<i>Studime e projekte</i>”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, vlerën 11,688,221 lekë.</p>   |
| 7 | <p>Nga verifikimi i llogarisë 202 “<i>Studime e kërtime</i>” për vitin <b>2018</b> rezultoi se <b>3</b> studime dhe kërtime në vlerën prej <b>1,882,999</b> lekë nuk kanë filluar të vihen në zbatim: -<i>Studim projektim “Ujësjellës Selo-Levinë-Krioner” me vlerë 834,999 lekë;</i> -<i>Studim projektim “Amfiteatri Sofratikë” me vlerë 528,000 lekë;</i> -<i>Studim projektim plani i mbarështimit të pyjeve me vlerë 520,000 lekë.</i> Për këto asete që njësia publike ka përllogaritur norma amortizimi në vlerën prej <b>282,449</b> lekë, rezultoi se, referuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05) <u>përcaktohet qartë se;</u> (projektet e studimet, kur janë për një aktiv konkret koston e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivitetit, pra amortizohen (shpërndahen) në totalin e shpenzimeve të ndërtimit të aktivitetit (situacioni+studimi+projektimi=kosto e plotë e aktivitetit). Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në</p>   | 35 -35 dhe Aneks C  | I lartë | <p>Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “<i>Studime e projekte</i>”, në mënyrë që në këtë llogari të mos amortizohen aktivitetet të cilat rezultojnë në proces dhe nuk janë të përfunduara dhe të merren masa për sistemimin e vlerës së përllogaritur të amortizimit 282,449 lekë duke kredituar amortizimin e akumuluar dhe debituar koston historike.</p>  |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

|    |   |                    |         |   |
|----|---|--------------------|---------|---|
|    | këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është i gabuar.   |                    |         |   |
| 8  | <p>Aktivitet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (210 “Toka, troje e terrene”, 211 “Pyje, Plantacione dhe Kullota” 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “ Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri , pajisje e vegla pune” , 215 “Mjete transporti”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhornuar pas bashkimit të njesive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra.</p> <p>Spektori i financës Bashkia Dropull për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë , aseteve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:</p> <p><b>-Ilog.(210)</b>“Toka, troje, terrene” vlera kontabël 198,582 lekë e pa ndryshuar.</p> <p><b>-Ilog.(211)</b>“Pyje, kullota, plantacione” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.</p> <p>Spektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.)</p> | 35 -36 dhe Aneks C |         | <p>Nga ana e Bashkisë Dropull të merren masa për të azhornuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe inventarizim.</p> <p>Titullari i njësisë publike Bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e aseteve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të bashkisë, ndërsa nga Spektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e Ilog.(210); Ilog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Dropull, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre aseteve.</p> |
| 9  | <p>Nga ripërformimi i amortizimit sipas normave të përcaktuara në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore vihat re Llogaria 215 “Mjete Transporti” amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 5,557,757 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitet paraqitet 6,549,997 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht <b>992,240 lekë</b> duke përdorur normë amortizimi 57% dhe jo 20% në kundërshtim me pikën 36 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore.</p>   | 36-37 dhe Aneks C  | I lartë | <p>Spektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 “Mjete transporti” duke e debituar në vlerën <b>992,240</b> lekë dhe sistemimin e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” duke e debituar në vlerën <b>1,668,075</b> lekë, të shkaktuara nga përlllogaritja e amortizimit me norma të gabuara të cilat kanë deformuar vlerën kontabël neto të tyre.</p>  |
| 10 | <p>Aktivitet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën 0 lekë.</p> <p>Në Bashkinë Dropull, është organizuar dhe funksionon shoqëria aksionare “Ujësjellës Kanalizime Dropull” sha., e cila sipas ekstraktit historik është një shoqëri e themeluar sipas statusit të miratuar datë 16.02.2018, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me NIPT L82616601E me kapitalin fillestar 5.000.000 lekë, me aksioner të vetëm Bashkia Dropull me kapital 100%.</p>   | 37-38 dhe Aneks C  | I mesëm | <p>Nga ana e Spektorit të Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë regjistrimin në kontabilitet të pjesmarrjes në aksione 100% me vlerë kontabël 5,000,000 lekë në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalin e vet”.</p>   |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

|    |  |                   |         |   |
|----|--|-------------------|---------|---|
|    | <p>Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrje të Bashkisë Dropull në “Ujësjetllës Kanalizime Dropull“ sh.a në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2018 në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, me urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesmarrje” pika 35.</p>   |                   |         |   |
| 11 | <p><b>1.</b> Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën <b>Janar – Dhjetor 2018</b>, për llogari të vitit 2017 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2017 paraqiten në vlerën 31,016,897 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 17,113,754 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej <b>13,903,143</b> lekë më pak (31,016,897-17,113,754). Bazuar në të dhënat e SIFQ detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2017 në bilanc duhet ti kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej <b>5,215,750</b> lekë. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në dt.31.12.2017 janë në vlerën prej <b>25,801,147</b> lekë, duhet të ishin paraqitur në bilanc të Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila për vitin 2017 është në vlerën 0 lekë, Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 25,801,147 lekë.</p> <p>Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 25,801,147 lekë.</p> <p><b>Për aktivitetin e vitit 2018</b>, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën <b>2,030,698 lekë</b> ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën <b>0 lekë</b>. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvritit të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore.</p> <p>Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Dhjetor 2018, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2012 paraqiten në vlerën 3,350,087 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 2,030,698 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej <b>1,319,389</b> lekë më pak (3,350,087-2,030,698). Bazuar në të dhënat e SIFQ detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2018 në bilanc duhet ti</p> | 39-40 dhe Aneks C | E lartë | <p>Sektori i Financës të paraqes një material ku të rakordojë me sistemin SIFQ gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën <b>3,350,087 lekë</b>, duke ndjekur radhën e pagesave.</p> <p>Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e palikujduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhave ushtrimore.</p> |





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

|    |  |                         |          |  |
|----|--|-------------------------|----------|--|
|    | <p>kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej <b>2,309,333</b> lekë. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në datë 31.12.2018 kanë vlerën prej <b>1,040,754</b> lekë, të cilat duhet të ishin paraqitur në bilanc të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”. Kjo llogari paraqitet në bilancin 2018 në vlerën 0 lekë. Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 1,040,754 lekë.</p>   |                         |          |  |
| 12 | <p>Teprica e Granteve kapitale të huaja përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute nga qeveri dhe institucione ndërkombëtare për investime. Në formatin 6 të pasqyrave ku përshkruhen Investimet dhe Burimet e Financimit është e paraqitur vlera 1,207,243 në llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”, ku rezulton se nga ana e Bashkisë Dropull mungon dokumentacioni dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktivitetëve në njësitë e sektorit publik”.</p>   | 40 - 41 dhe Aneks C     | I mesëm  | <p>Nga Sektorit i Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë sistemin në kontabilitet të vlerës <b>1,207,243</b> duke debituar llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”.</p>  |
| 13 | <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, Bashkia Dropull, me vlerë të kontratës 137,897,895 lekë me TVSH, fituar nga BOE “E... &amp; 4 A...” SHPK Tiranë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,854,605 lekë pa TVSH, për zërat e punimeve: Shtresë çakulli t=15 cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri; Shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe, 3 cm, me makineri. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1198 prot, datë 20.09.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe sipërmarrësit BOE “E... &amp; 4 A...” SHPK</p> | 47 – 49 dhe Aneks D/4/1 | E lartë. | <p>Bashkia Dropull, të merren masa për kompensimin e vlerës prej <b>1,854,605 lekë pa TVSH</b> për volumet e punimeve të pakryera nga BOE “E... &amp; 4 A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1198 prot datë 20.09.2017, me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> |
| 14 | <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull”, me vlerë të kontratës 85,316,927.31 lekë me TVSH, fituar nga OE “A...” SHPK Tiranë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 617,500 lekë pa TVSH, për zërat e punimeve: Zëri “Transport të materialeve të prishura (mbeturina)”; Zëri “F.V Hekur betoni periodik”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 875/1 prot, datë 26.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe sipërmarrësit OE “A...” SHPK</p>   | 49 – 51 dhe Aneks D/4/2 | E lartë. | <p>Nga Bashkia Dropull, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 617,500 lekë pa TVSH nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 875/1 prot datë 26.09.2016, me objekt “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>                                      |
| 15 | <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “<b>Ujësjetësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës</b>”, Bashkia Dropull, me vlerë të kontratës (me tvsh)</p>   | 51 – 54 dhe Aneks D/4/3 | E lartë. | <p>Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 947,400 lekë pa tvsh nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën</p>  |





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

|    |  |                               |          |   |
|----|--|-------------------------------|----------|---|
|    | 68,995,558 lekë, fituar nga OE “A...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 947,400 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmartjes së punimeve nr. 1523 prot datë 29.12.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE “A...” SHPK  |                               |          | me nr. 1523 prot datë 29.12.2016, me objekt “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.  |
| 16 | <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull, me vlerë të kontratës 68,995,558 lekë me TVSH, fituar nga OE “A...” SHPK, u konstatua që është firmosur një amendament kontrate pa nr. prot, datë 25.04.2017, ku bëhet shtyrja e kontratës me 90 ditë, ose deri në datën 29.07.2017, i cili nuk është plotësisht e argumentuar.</p> <p>Nga auditimi i ditarit të punimeve rezulton se janë ndërprerë punimet vetëm me 32 ditë (Janari 2017), ndërsa punimet kanë zgjatur 186 ditë (66 ditë pas përfundimit të afatit kontraktual të punimeve). Nga sa sipër, është e argumentuar shtyrja e afatit vetëm për 32 ditët e motit të papërshtatshëm. Arsyeja e shtyrjes së afatit për shkak të shpronësimeve nuk duhej marrë në konsideratë nga AK, pasi sipas aktit të dorëzimit të sheshit të firmosur nga të dyja palët e kontratës, sheshi është i lirë.</p> <p>Nëse do të ishte bërë amendamenti i shtyrjes së punimeve vetëm me 32 ditë, nga ana e AK duhet të ishin aplikuar penalitete për sipërmarrësin, në zbatim të nenit 34, pika, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, në vlerën <b>4,595,323 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash nga penalitetet në Bashkinë Dropull</b></p> | 51 – 54 dhe<br>Aneks<br>D/4/3 | E lartë. | Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa për shqyrtimin me përgjegjësi të kërkesave të sipërmarrësit apo mbikëqyrësit në lidhje me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, me qëllim vënien e objekteve në efikasitet, për arritjen në kohë të impaktit tek qytetarët, si dhe respektimin e kontratës përsa i takon vonesave në përfundimin e punimeve. |
|    | <p>Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nga auditimet e mëparshme, rezultoi se:</p> <p><b>Masa Organizative:</b> Janë rekomanduar 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, është në proces zbatimi 1 masë.</p> <p><b>Masa shpërblim dëmi:</b> Janë rekomanduar 8 masa me vlerë 4,988,342 lekë, shumë e cila është kontabilizuar.</p> <p>Deri me datë 31.06.2019, rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 4,988,342 lekë janë realizuar 3,838,290 lekë, ndërsa shuma 1,150,052 lekë nuk është arkëtuar..</p> <p><b>Nga të cilat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në proces arkëtimi 2 rekomandime në vlerën 574.363 lekë</li> <li>-Janë nisur njoftimet për 4 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet 575.689 lekë.</li> </ul>  | 54 – 55 dhe<br>Aneks E        | I mesëm  | Kryetari i Bashkisë Dropull të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.   |

#### I.c. OPINIONI I AUDITIMIT

#### Opinionit i auditimit



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

#### **Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull, për vitin ushtrimor, nga 1 Janar 2018 deri 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

#### **Opinion i pakualifikuar me rezervë:**

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Modifikuar me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2017, referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion e pakualifikuar me rezervë: Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se menaxhimi i subjektit, mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare nëse atij nuk do t'i vihen në dukje rezervat që kemi për çështje specifike të pazakonta të konstatuara:

#### **Baza për Opinionin e pakualifikuar me Rezerve”**

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për rezervat në opinion te fakti se nuk jemi dakord për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si vijon:

**-Llogaria 202 “Studime dhe Projektme”** me vlerë në bilancin kontabël për vitin 2018 **6,263,032 lekë**, konstatohet se disa studime e projektme në vlerën **11,688,221 lekë**, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Dropull dhe nuk janë klasifikuar si Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara, në kundërshtim me nenin nr.7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

-Për vitin 2018 rezulton se 3 studime dhe kërkime në vlerën prej **1,882,999 lekë** nuk kanë filluar te vihen në zbatim, Për këto asete ndërkohë që njësia publike ka përlogaritur norma amortizimi në vlerën prej **282,449 lekë**, rezulton se, referuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05) përcaktohet qartë se; (projektet e studimet, kur janë për një aktiv konkret koston e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivit, pra amortizohen (shpërndahen) në totalin e shpenzimeve të ndërtimit të aktivit (situacioni + studimi + projektimi = kosto e plotë e aktivit). Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është i gabuar.

**-Llogaria 215 “Mjete Transporti”** amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 5,557,757 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet **6,549,997 lekë**, pra janë ngarkuar padrejtësisht 992,240 lekë në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, seksioni nr. II, VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 pika nr.40.

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 12,634,887 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 14,322,963 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht 1,668,075 lekë, në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 pika nr.40

**-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet** “Aktivet Financiare paraqitet në vlerën zero në bilancin kontabël 2018 edhe pse Bashkia Dropull zotëron 100% aksione në pjesëmarrje tek “Ujësjiellës Kanalizime Dropull” sh.a me vlerë 5,000,000 lekë , kjo pjesëmarrje në kapitalin e vet në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2018 në kundërshtim me nenin 7 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35.

**- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në bilanc për vitin 2018 në vlerën 0 lekë. Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 1,040,754 lekë.

Duke u bazuar tek udhëzimi i drejtorisë së thesarit mbështetur dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku specifikohet që detyrimet e prapambetura të raportohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe jo në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Pra shuma prej 1,040,754 lekë përbën tashmë vetëm detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2018.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 1,040,754 lekë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat janë me vlerë kontabël 1,040,754 lekë është në kundërshtim me pikën nr. 3.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”.

**-Aktivet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (210 “Toka, troje e terrene” , 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “ Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri , pajisje e vegla pune” , 215 “Mjete transporti”)** nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhurnuar pas bashkimit të njërive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra. Nuk është hartuar regjistër kontabël ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit , vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim, si dhe identifikohet problematika për moskryerjen e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

inventarizimit vjetor të tyre në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### - (Llog. 106) Teprica e Granteve kapitale të huaja

Teprica e Granteve kapitale të huaja përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute nga qeveri dhe institucione ndërkombëtare për investime. Në formatin 6 të pasqyrave ku përshkruhen Investimet dhe Burimet e Financimit është e përcaktuar vlera 1,207,243 në llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”, dhe nga ana e Bashkisë Dropull mungon dokumentacioni dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj. Për këtë mangësi në dokumentacion në Llog.106 “Teprica e Granteve kapitale të huaja” të Bilancit Kontabël të aktivitetit të dhuruar me vlerë kontabël 1,207,243 lek rezulton në kundërshtim me pikën nr. 1.1.2 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, dhe me udhëzimin e MF nr.8 datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”.

- Përpara zbatimit të **vendimit gjyqësor**, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për **arkëtimin e debitorëve** nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, **në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë** (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë).

#### **Opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Dropull**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Dropull, gjatë periudhave ushtrimore 6 mujori i dytë i vitit 2016, 2017 dhe 2018.

**Opinion i pakualifikuar me rezervë.** Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Dropull, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e modifikuar me rezervë”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator për sa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi. **Kemi konstatuar se:**

- Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi se nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

- Në auditimin e 3 kontratave për punë civile u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm të punimeve, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, për vlerën gjithsej **3,419,505 lekë** konkretisht:

- a. “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I” u konstatua dëm ekonomik në shumën **1,854,605lekë;**



## KONTROLLI I LARTË I SHITIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

- b. “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull”, u konstatua dëm ekonomik në shumën **617,500 lekë**;
- c. “Ujësjetllësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës” u konstatua dëm ekonomik në shumën **947,400 lekë**;

Gjithashtu u konstatua përdorim pa efektivitet i fondeve në kontratën me objekt “Ujësjetllësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, në shumën **4,595,323 lekë**.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit publik u konstatua në tre raste devijime në procedura me vlerë nën materialitet.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Dropull**

Drejtimi i Bashkisë Dropull, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.





## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.368/1, datë 28.05.2019 “Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Dropull”, dhe shkresës nr. 368/2, datë 04.07.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.06.2019 deri më datë 09.08.2019., në subjektin Bashkia Dropull për periudhën nga 01.01.2017 – 30.06.2019, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **L.B., Përgjegjës Grupi**
2. **D.K., Auditues**
3. **A.H., Auditues**
4. **S.M., Auditues**
5. **A.Z., Kryeauditues.**

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Dropull.

**Marrësi:** Bashkia Dropull.

**Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull, për vitin 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi. Auditimi u shtri në vlerësimin e pasqyrave të Bashkisë Dropull.

**Oëllimi i auditimit** të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

**Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.





## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Dropull.

#### **Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dropull, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë Dropull, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

#### **Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e auditimit**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorin publik”.

-UMF nr. 14, datë 28.12.06, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

#### **Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:**

Administratori i Përgjithshëm (Nëpunësi autorizues) z. A.D. - Kryetar i Bashkisë Dropull dhe (Nëpunësi zbatues) znj. T.P. – Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dropull.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku thuhet se: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
  - b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
  - ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
- Neni 65; “Administrata e njësisë administrative”, pika 1. “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

#### **Përgjegjësitë e audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Dropull dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

#### **Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:**

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*

**Ekzistenca:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

**Plotësia:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 0 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

-UMF nr. 14, datë 28.12.06, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.

-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

**Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, për vitin 17, në shumën **2,856** mijë lekë, për vitin 2018 vlerën **3,270** mijë lekë dhe për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

#### **Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:**

**1. Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

**2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.11 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

**4. Kontrolli i vlerësimit.** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

**5. Konfirmim nga të tretët,** Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

**6. Kontrolli sipas një treguesi.** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

#### III PËRSHKRIMI AUDITIMIT

##### Informacioni i Përgjithshëm:

**Zona Gjeografike:** Dropulli kufizohet në veri me bashkinë Libohovë. Kryeqendra e Bashkisë është Jorgucati.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.503 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 23.131 banorë. Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km<sup>2</sup> me një densitet prej 49.56 banorë/km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastrë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 41 fshatra.



##### Profili i bashkisë

Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të pakicës etnike greke në Shqipëri. Derviciani njihen nga vendasit si kryeqendra e zonës, pasi në të zhvillohen pothuajse të gjitha aktivitetet e rëndësishme politike, kulturore dhe fetare të minoritetit. Megjithatë, qendra e komunës do të jetë në Jorgucati, një pikë e ndërmjetme mes dy komunave që ishin më parë.

Zonat e minoritetit kanë njohur viteve të fundit përmirësim të infrastrukturës rrugore në brendësi të fshatrave të vegjël që shtrihen mes kodrave, përgjatë rrugës që lidh Gjirokastrën me Kakavijën. Falë granteve qeveritare, por edhe ndihmave financiare nga Greqia, shumë fshatra kanë zgjidhur edhe problemet e ujit të pijshëm. Por në këto 25 vite të tranzicionit, zonës së Dropullit i është rikthyer plaga e vjetër e emigracionit, vala e parë e së cilës nisi në vitet '20-'30. Në fshatrat e Dropullit mungojnë moshat e reja, shumë shtëpi janë mbyllur me vite dhe shumë toka kanë mbetur djerrë. Krahina e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar vallen e bukur të krahinës, kostumet e pasura dhe motivet epirote të klarinetës.

##### Sfidat me të cilat do të përballen pushteti vendor pas ndarjes së re:

Ri integrimi i emigrantëve që kthehen nga Greqia e prekur prej krizës ekonomike dhe financiare është një nga sfidat e bashkisë së re. Drejtuesit e rinj vendorë duhet të përballen me problemet që kanë disa fshatra më në thellësi, duke rritur presionin tek strukturat qeveritare për më shumë siguri nga vjedhjet dhe dëmtimet e pronës. Bashkia e Dropullit duhet të llojë për financime të reja për ndërtimin e ujësjellësve dhe rikonstruksionin e rrugëve si dhe për mbështetjen e shtresave në nevojë në disa fshatra. Një sfidë tjetër konsiderohet mbrojtja e territorit, sidomos nga aktivitetet e gurore apo shfrytëzimit të pyjeve pa kriter.

Bashkia ka shumë përgjegjësi në përmirësimin e sektorit arsimor dhe sidomos qendrave shëndetësore, duke qenë se zonat banojnë nga mosha të thyera që kanë nevojë për asistencë mjekësore. Bashkia e re duhet të hartojë programe të posaçme për sektorin bujqësor, sidomos për shfrytëzimin e Fushës së Dropullit.

Në mjaft prej zonave, sipërfaqet e tokës nuk punohen prej vitesh dhe ka shumë probleme si gjatë përmblytjeve në dimër (kullimin e tokave) edhe me mungesën e vaditjes në verë.

Ka nisma të reja për ferma të vogla bujqësore dhe është detyrë e njësisë së re të hartojë politika për mbështetjen e tyre.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

#### Njësitë administrative, qytetet dhe fshatrat

| Qarku       | Qendra e Bashkisë | Njësitë administrative sipas RAT | Qytetet dhe fshatrat nën jurisdikcion të bashkisë   | Popullsia sipas Censurës 2011 | Popullsia sipas Regjistrimit Civil | Sipërfaqja KM <sup>2</sup> |
|-------------|-------------------|----------------------------------|---|-------------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| Gjirokastër | Fshati Sofratikë  | Drepu i Poshtëm                  | Fshatrat: Dervican, Goranë, Vazisht, Haskovë, Dhurjan, Sofratikë, Tenhat, Gorica, Frashtan, Ligar, Grapsh, Peshkëpia Siperme, Peshkëpia e Poshtme, Glinë, Wrahogoranci, Radat | 3,503                         | 22,121                             | 466.67                     |
|             |                   | Drepu i Sipërm                   | Fshatrat: Jorgucat, Zëvit, Belarat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishtar, Selo, Likomil, Uovinë, Kriqaner, Sobinë, Ullingo, Koshovicë, Dintë, Kakavie, Vrisera          |                               |                                    |                            |
|             |                   | Pogon                            | Fshatrat: Polican, Skore, Sopik, Çatistë, Mavrejer, Hllomo, Seldol  |                               |                                    |                            |

**Misioni për njësinë që auditohet** është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

**Objektivat** burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni* ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet:* njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A.MBI PLANIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E RISKUT.

###### Oasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, vlerën 3,577,290 lekë për tu konsideruar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

###### Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

###### - Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në ndërmarrje nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisë ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

###### - Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

###### - Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur (3,577,290 lekë) u filtruan:

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2017 në vlerën totale 28,229,000 lekë.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2018 në vlerën totale 30,456,381 lekë.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

###### - Kontabiliteti:

Në nenin 10 të Ligjit nr. 9228, dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. (SKK 1) i përmirësuar.

Mos aplikimi i rregullave kontabël mbi bazën e parimit të kontabilitetit pra mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur para ja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t’u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, për vitin 17, në shumën **2,856** mijë lekë, për vitin 2018 vlerën **3,270** mije lekë dhe për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht përcaktimi i riskur dhe materialitetit për Bashkinë Dropull për vitet 2017 e 2018, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat paraqitet në tabelat nr.1 dhe nr.2 sa më poshtë vijon:

**Tabela nr.1 “Bashkia Dropull, plani ne total, të dhëna të tjera mbi planin në lidhje me shpenzimet”**

| Emërtimi i Shpenzimeve            | Viti 2017          |                            |                          | Viti 2018          |                            |                          |
|-----------------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------------|
|                                   | Vlera e Popullatës | Faktori i Riskut (0.7-2-3) | Çështje për tu shqyrtuar | Vlera e Popullatës | Faktori i Riskut (0.7-2-3) | Çështje për tu shqyrtuar |
| Paga (600)                        | 57,640,705         | 0.70                       | 17                       | 63,667,020         | 0.70                       | 17                       |
| Sigurime Shoqërore (601)          | 9,333,003          | 0.70                       | 3                        | 10,577,242         | 0.70                       | 3                        |
| Mallra e Shërbime (602)           | 40,208,100         | 0.70                       | 12                       | 51,344,751         | 0.70                       | 14                       |
| Investime të brend. (230-231)     | 0                  | 2.00                       | 0                        | 0                  | 2.00                       | 0                        |
| Te tjera transfer. korrente (606) | 35,621,572         | 0.70                       | 11                       | 37,911,437         | 0.70                       | 10                       |
| <b>Total</b>                      | <b>142,803,380</b> |                            |                          | <b>163,500,450</b> |                            |                          |
| Materialiteti në %                | 2%                 |                            |                          | 2%                 |                            |                          |
| <b>Materialiteti në vlerë</b>     | <b>2,856,068</b>   |                            |                          | <b>3,270,009</b>   |                            |                          |
| Kalkulimi i precizionit           |                    |                            |                          |                    |                            |                          |
| <b>Materialiteti</b>              | <b>2,856,068</b>   |                            |                          | <b>3,270,009</b>   |                            |                          |
| Gabimi i lejuar (10% - 20%)       | 285,607            |                            |                          | 327,001            |                            |                          |
| <b>Nëntotali</b>                  | <b>2,570,461</b>   |                            |                          | <b>2,943,008</b>   |                            |                          |
| Precizioni i planifikuar (80-90%) | 90%                |                            |                          | 90%                |                            |                          |
| <b>Vlera e precizionit</b>        | <b>2,313,415</b>   |                            |                          | <b>2,648,707</b>   |                            |                          |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull.*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

**Tabela nr.2 “Bashkia Dropull, plani ne total, të dhëna të tjera mbi planin, në lidhje me të ardhurat”.**

| Emërtimi i të ardhurave            | Viti 2017          |                            |                          | Viti 2018          |                            |                          |
|------------------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------------|--------------------|----------------------------|--------------------------|
|                                    | Vlera e Popullatës | Faktori i Riskut (0.7-2-3) | Çështje për tu shqyrtuar | Vlera e Popullatës | Faktori i Riskut (0.7-2-3) | Çështje për tu shqyrtuar |
| Të ardhurat nga buxheti            | 147,775,056        | 0.70                       | 19                       | 161,353,406        | 0.70                       | 19                       |
| Të ardhurat e veta                 | 197,046,419        | 0.70                       | 25                       | 205,227,271        | 0.70                       | 24                       |
| <b>Total</b>                       | <b>344,821,475</b> |                            |                          | <b>366,580,677</b> |                            |                          |
| Materialiteti në %                 | 2%                 |                            |                          | 2%                 |                            |                          |
| <b>Materialiteti</b>               | <b>6,896,430</b>   |                            |                          | <b>7,331,614</b>   |                            |                          |
| Kalkulimi i precizionit            |                    |                            |                          |                    |                            |                          |
| <b>Materialiteti</b>               | <b>6,896,430</b>   |                            |                          | <b>7,331,614</b>   |                            |                          |
| Gabimi i lejuar (10%-20%)          | 689,643            |                            |                          | 733,161            |                            |                          |
| <b>Nëntotali</b>                   | <b>6,206,787</b>   |                            |                          | <b>6,598,452</b>   |                            |                          |
| Precizioni i planifikuar (80 -90%) | 90%                |                            |                          | 90%                |                            |                          |
| <b>Vlera e precizionit</b>         | <b>5,586,108</b>   |                            |                          | <b>5,938,607</b>   |                            |                          |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull.*

### A/3. KONTROLLI I BRENDSHËM.

**Gjetje nr.1**      **Mbi zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Dropull.**

**Situata:** Bashkia Dropull, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësonin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave

**Kriteri** Pika 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

**Impakti Shkaku** Ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

**Rëndësia:** E lartë  
**Rekomandimi** Bashkia Dropull të marrë masa, të dërgojë në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësonin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse.

**Afati për zbatim** për Menjëherë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

#### Gjetje nr.2 Mbi Njësine e Auditimit të Brendshëm.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, e cila, për vitin 2016 funksiononte në nivel sektori, ndërsa për vitin 2017 e në vazhdim, kjo njësi funksionon në nivel drejtorie.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dropull, është strukturë e cila mbulon me shërbim auditimi dhe Bashkinë Libohovë sipas Akt marrëveshjes për realizimin e Shërbimit të auditimit të brendshëm, me nr.328/1 të ofertuesit dhe nr.319 të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1, datë 01.04.2016, si dhe Bashkinë Finiq sipas Akt Marrëveshjes nr.1333 të ofertuesit dhe nr.2465 të përfituesit, datë 04.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13748/1, datë 31.10.2016.

Ky shërbim është realizuar në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ku ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në realizimin e objektivave, bazuar në Ligjin nr 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manuali i Auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, Kodin dhe Kartën e Auditimit, miratuar me VKM nr.345, datë 01.06.2004 dhe Metodologjinë e Auditimit Financiar, miratuar me VKM nr.806, datë 06.12.2006, ku ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet implementimit të Planit Vjetor, ku përcaktohen qartë objektivat për t’u arritur, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Kjo strukturë e cila është e organizuar në nivel Drejtori, funksionon me 5 auditues, përfshirë edhe drejtuesin e Njesisë, ku profili arsimor të audituesve të punësuar pranë kësaj strukture, rezulton që ata të jenë të diplomuar në fushën e ekonomisë.

Per vitin 2017, është 1 auditim i kombinuar ne Bashkine Dropull dhe për vitin 2018 auditimi është në proces evadimi.

**Situata:** NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj nuk është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve.

**Kriteri** Ligji nr. 114/2015 datë 06.11.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, VKM nr.212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”

**Impakti** Mundësia e moszbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

**Shkaku** Mosplanifikim i auditimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi** Nga Bashkia Dropull të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të kryejë monitorimi e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**Afati për Menjëherë zbatim**

Më hollësisht trajtuar në ANEKS A, bashkëlidhur materialit.

#### **Komente dhe sqarime të ardhura me shkresën nr. 402/1, datë 03.09.2019 dhe të protokolluara në KLSH me nr.368/4, datë 09.09.19.**

Observacionet që kemi lidhur me Projekt raportin si dhe dokumentacionin që justifikon dhe mbështet kundërshtimet tona dhe konkretisht:

#### **Se pari :**

Rekomandohet ritja e efikasitetit të Njesisë së Auditimit të brendshëm, por nga grupi i kontrollit nuk analizohet dhe as dokumentohet mundësi e efikasitetit në veprimtarinë e NJAB, por theksohet në materialin Tuaj të auditimit se janë zbatuar standardet e Auditimit në organizim dhe funksionim në të gjitha fazat e procesit të auditimit dhe nuk përmendet asnjë rast kur këto standarde të mos janë zbatuar ose të jete vepruar në kundërshtim me ligjin.

Nga NJAB dokumentohet planifikimi vjetor i auditimeve, njoftimi, realizimi i tyre sipas planifikimit, komunikimi me personat e interesuar, dhe dokumentacioni përfundimtar si dhe komunikimi i gjetjeve nga auditimi tek titullari i institucionit si dhe tek personat përgjegjës së bashku me rekomandimet.

Gjithashtu bashkëpunimi me Audituesit e KLSH ka qenë permanent si dhe janë njoftuar edhe institucionet përkatëse që monitorojnë veprimtarinë e institucionit që drejtohet prej meje.

Në lidhje me rekomandimin që si njësi duhet të përgatisim dhe paraqesim raporte të përmbledhura para këshillit bashkiak, ky veprim nuk është detyrim ligjor për NJAB sepse ky raport i paraqitet Kryetarit të bashkisë, sipas ligjit me nr 114/2015 “Per auditimin e brendshëm” kreu IV, neni 10, pika 2 thotë se “Njesia e auditimit të brendshëm është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtperdrejtë tek titullari i njesisë publike”.

#### **Se dyti:**

Nga NJAB Bashkia Dropull ka qenë dhe mbetet prioritet vlerësimi i riskut dhe kjo pasqyrohet në Faktin e planifikimit të auditimeve, pasqyrimin e gjetjeve dhe rekomandimet që jepen për të minimizuar deri në eliminim faktorët e riskut në veprimtarinë e njesive që në auditojmë si dhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve në fushat e riskut me prioritet.

#### **Se treti :**

Konstatimi i Grupit të kontrollit se nga NJAB nuk është realizuar kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer, nuk është fakt i provuar pasi vetë auditimi realizohet i gërrshetur dhe elementet e kontrollit janë edhe nga institucione jashtë NJAB, sikurse është edhe kontrolli që realizohet dhe paraqitet ky observacion dhe sipas Projekt raportit që po diskutojmë nuk rezultojnë të këtu gjetje që nuk rakordojnë me auditimet e realizuara nga NJAB, por janë të njëjtat rezultate dhe kjo konfirmon saktësinë e auditimit dhe cilësinë e punës së NJAB Bashkia Dropull, si dhe për Bashkinë Libohovë.

#### **Se katërti:**

Fakti që NJAB Bashkia Dropull fillimisht u krijua si strukturë në nivel sektori pranë Bashkisë Dropull dhe me sugjerim nga Kryetari i Bashkisë dhe nga auditet u realizuan bashkëpunim edhe me Bashkinë Libohovë dhe Bashkinë Finiq, tregon përgjegjësinë në administrim të fondeve si dhe menaxhimin e tyre, por njëkohësisht krijoi kushtet dhe terrenin që në njesitë e audituara të këtu personelin për të mundur veprimtarinë jashtë parajgjyqimeve dhe, në ushtrim të sistemit të vetëkontrollit në auditim.

Po kështu në këtu material observacioni do të parashtroj duke sjelle në vëmendjen tuaj disa fakte që vlerësoj se mund dhe duhet të rishikoni në ndryshim nga materiali (në konkluzione dhe në rekomandimin e lene) që keni depozituar pranë nesh me dt. 19.08.2019 me nr Prot 368/3 dhe konkretisht do të parashtroj vlerësimin tim se në disa nga konkluzionet apo dhe rekomandimin, që ju keni depozituar nepermjet Projekt Raportit të Auditimit janë jo të sakta dhe në përputhje me dokumentacionin që keni trajtuar ju apo dhe që disponon njesia e auditimit të brendshëm në këtu bashki, e përkatësisht:

- Në faqen 68, të projekt raportit “ Mbi krijimin e njesisë së auditimit të brendshëm publik” është trajtuar se: “Sherbimi i AB është realizuar në zbatim të ligjit nr 114/2015 “Per auditimin e brendsahem në sektorin publik”, ... si dhe të ligjit nr 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”.... ku ushtron veprimtarinë e saj nepermjet implementimit të planit vjetor, ku përcaktohen qarte objektivat për t’u arritur, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut”.

- Në faqen 69 dhe 71, të projekt raportit “Realizimi i programit të auditimit” është trajtuar se: “...Mbeshtetur në programet vjetore të miratuara, veprimtaria audituese e kesaj njesie i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet, procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e Auditimit të brendshëm dhe udhëzimit në fuqi, në fushën e auditimit të brendshëm”.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

- Ne faqen 72, te projekt raportit “Zbatimi i planeve te auditimit te brendshem. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit te auditimit”, eshte trajtuar se: “Per veprimtarine e sektorit te auditimit te brendshem, per periudhen nga data 01.01.2017 e ne vijim, i eshte raportuar ne menyre sistematike Kryetarit te Bashkise. Per veprimtarine e kesaj Njesie Auditimi, qe kur eshte ngritur si strukture, ka raport permbledhes dhe shkrese percjellese, perkatesisht per vitin 2016 me nr 54/1 date 14.02.2017, per veprimtarine e vitit 2017, me nr 74/1, date 14.02.2018, si dhe per veprimtarine e vitit 2018, me nr 199/2, date 14.02.2019, te cilat jane derguar ne Ministrine e Financave. ( Njesia Qendrore te Harmonizimit per Auditimin e Brendshem).

- Ne faqen 69 dhe 70,te projekt raportit “Realizimi i programeve te auditimit” eshte trajtuar se: “ ...kjo njesi auditimi ka ushtruar veprimtarine e saj nepermjet implentimit te planit vjetor, ku jane percaktuar qarte objektivat per te arritur, kapacitetet ne dispozicion si dhe vleresimimi i menaxhimit te riskut.

Nga ana e kesaj njesie eshte kryer sherbimi konsulence, ne dy drejtime qe ishin me risk te larte ne momentin e krijimit te bashkive te reja. Sherbimi i cili realizohet ne çdo moment kur kerkohet nga titullari i Institucionit.

Ne lidhje me problematikat e hasura gjate zbatimit te reformes Administrativo – teritoriale.

Ne lidhje me zbatimin e reformes per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem, veprime te cilat perbejne nje hap domethenes ne rrugen per rritjen e autoritetit vendimarres e administrativ te njesive vendore, ne krijimin e shoqerive anonime ne administrimin e burimeve ujore”.

- Ne faqen 70, te projekt raportit “Realizimi i programeve te auditimit” eshte trajtuar se:

“...nga kjo njesi jane kryer auditime perputhshmerie, ne njesite administrative ne te tre bashkite, ku drejtimi i kryerjes se ketij auditimi ishte per te vleresuar krijimin dhe funksionimin e Njesive Administrative, ne lidhje me menaxhimin efektiv te burimeve njerezore si aset me peshe potenciale ne impaktin qe jep ne implementimin e reformes, zbatimin efektiv te saj dhe mbulimin me efçenc te sherbimeve qe duhet ti afrohen komunitetit me cilesi sa me te larte dhe nje kohe sa me te shkurter.

- Pra ne çdo element te trajtuar nga ana e Juaj del qarte, se auditimet e realizuara ne te gjitha njesite qe auditohen nga Njesia e Auditimit te brendshem, jane realizuar auditime te thelluara , ku eshte kryer programi i auditimit, duke permbledhur orientimet kryesore te veprimit ne perputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, si dhe permbajne ne menyre te qarte emertimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhen dhe afatin e auditimit, drejtimet qe do te ndiqen dhe grupin e auditimit. Vend te veçante ne program zene dhe ndjekja e zbatimit te rekomandimeve te dhena nga auditimet e meparshme, si dhe referencat ligjore te vena ne programet e auditimit qe reflektojne ne kuadrin ligjor ne fuqi.( Veprimtaria jone eshte kryer sipas percaktimeve te bera ne Manualin e Auditimit te brendshem, kap. VI, “Evidentimi dhe dokumentimi i punes audituese”).

Mbi konstatimet e bera ne auditimet qe jane realizuar nga NJAB, nga grupi i auditimit, eshte bere vleresimi i funksionimit te çdo sistemi , jane trajtuar qarte dhe sakte gjetjet si dhe jane lene rekomandimet e duhura, per permiresimin e gjendjes dhe arritjen e objektiveve nga Institucioni. Fakt ky qe ju e keni analizuar ne trajtimin e materialit tuaj.

Pranohet se nga ana e njesise se auditimit nuk eshte kryer monitorimi i zbatimit te rekomandimeve, kjo sipas pikes 4.1.13.1. te MAB, por duhet theksuar se ndjekja e zbatimit te rekomandimeve behet tek auditimi i radhes, kjo sipas kerkesave te pikes 4.1.13.2 te MAB. Veprim qe ne çdo auditim te radhes ne e planifikojme ne programin e angazhimit.

**Sqarim: Mbas shqyrtimit të komenteve dhe dokumentacionit shtesë që ju keni paraqitur, komentet tuaja merren në konsideratë me përjashtim të faktit që ju nuk keni monitoruar zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.**

**B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017“Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.**

*1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017 dhe 2018;*

*2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;*

*3.Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;*

*4 Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*

*4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuIduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikuIduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF)*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

*5.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;*

Në Bashkinë Dropull buxheti i vitit 2017 dhe 2018 është hartuar kryesisht mbi bazën e dhjetë programeve të cilat janë: Programi i administratës vendore; i menaxhimit mbetjeve, shërbime publike, i arsimit parauniversitar dhe edukimit, i arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave, i administrimit të pyjeve, i kullimit, ujitjes, i transportit rrugor (rrugët rurale) dhe (rrugët e brendshme) dhe i Ujësjellës Kanalizimeve

Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Dropull është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.2, datë 27.01.2017 “Përmiratimin e buxhetit të Bashkisë Dropull”, është miratuar buxheti nga të ardhurat vendore në vlerën 179,832 mijë lekë dhe shpenzimet 179,832 mijë lekë dhe me VKB nr. 29, datë 31.05.2017 “Për miratimin e buxhetit shtesë të transfertave specifike” për shumën 530,927lekë. Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2017, **është bërë jashtë afateve ligjore**, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: Neni 32. Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre. Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Për vitin 2018, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 21.12.2017, në vlerën 192,977 mijë lekë nga të ardhurat vendore, transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike, me VKB nr.10, datë 20.02.2018 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Dropull për vitin 2018”, për shumën 2,285 mijë lekë.

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2017 dhe 2018 krahasuar me planin e PBA

në /000 lekë

| Nr. | Emertimi                            | Plani i buxhetit 2017 | Plani i vitit 2017 në PBA | Diferenca     | Plani i buxhetit 2018 | Plani i vitit 2018 në PBA | Diferenca     |
|-----|-------------------------------------|-----------------------|---------------------------|---------------|-----------------------|---------------------------|---------------|
| 1   | Shpenzime personeli (600,601)       | 68,021                | 51,496                    | 16,525        | 80,536                | 76,673                    | 3,863         |
| 2   | Shpenzime korrente(602,604,609,606) | 61,216                | 51,960                    | 9,256         | 65,791                | 56,281                    | 9,510         |
| 3   | Shpenzime investimi (230/231)       | 51,126                | 11,198                    | 39,928        | 48,935                | 5,086                     | 43,849        |
|     | <b>Total gjithsej</b>               | <b>180,363</b>        | <b>114,654</b>            | <b>65,709</b> | <b>195,262</b>        | <b>138,040</b>            | <b>57,222</b> |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

Për vitet 2017 dhe 2018 buxhetet janë miratuar të balancuara dhe pa defiçite. Buxhetet e dy viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga prefektura e Qarkut Gjirokastrë. Për vitin 2017 buxheti është miratuar me VKB nr.2, datë 27.01.2017 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkesën nr. 204/1, datë 13.02.2017. Për vitin 2018 me VKB nr.59, datë 21.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkesen nr. 2783/1, datë 05.01.2018.

Realizimi i treguesve të buxhetit për periudhën 2017 – 2018, paraqitet:

në 000/lekë

| Nr. | Emërtimi                   | Viti 2017 |        |           | Viti 2018 |        |          |
|-----|----------------------------|-----------|--------|-----------|-----------|--------|----------|
|     |                            | Plan      | Fakt   | Realiz. % | Plan      | Fakt   | Realiz.% |
| 1   | Paga 600                   | 62,194    | 57,641 | 92.7      | 71,449    | 63,858 | 89.4     |
| 2   | Sigurime shoqërore 601     | 9,943     | 9,333  | 93.9      | 11,592    | 10,577 | 91.2     |
| 3   | Shpenz.operative 602       | 59,957    | 40,208 | 67        | 60,076    | 51,295 | 85.4     |
| 4   | Subvension ujësjellësi 603 |           |        |           | 2,000     | 1,999  | 100      |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

| Nr.                               | Emërtimi                   | Viti 2017      |                |             | Viti 2018      |                |             |
|-----------------------------------|----------------------------|----------------|----------------|-------------|----------------|----------------|-------------|
|                                   |                            | Plan           | Fakt           | Realiz. %   | Plan           | Fakt           | Realiz.%    |
| 5                                 | K.Qarkut Emergj.civile 604 | 736            | 1              | 1           | 5,365          | 5,050          | 94.1        |
| 6                                 | Nd ekonomike invalid 606   | 36,728         | 36,684         | 99.9        | 37,720         | 37,720         | 100         |
| 7                                 | Investime 231              | 146,348        | 126,200        | 86.2        | 200,460        | 174,185        | 86.9        |
| <b>Total buxheti me ndryshime</b> |                            | <b>315,906</b> | <b>270,067</b> | <b>85.5</b> | <b>388,662</b> | <b>344,684</b> | <b>88.7</b> |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

- Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2018, Bashkia Dropull ka një detyrim ndaj të tretëve prej 17,113,754 lekë në fund të 2017, për tu paguar në 2018 (llogaria 486, furnitor e llogari të lidhura me to) dhe 2,030,698 lekë në fund të 2018, për tu paguar në 2019. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91- Detyrimet e prapambetura të Njësitve të Vetëqeverisjes Vendore.

***Faturat e palikuiduara janë likuiduar të gjitha 6/Mujorin e parë të vitit 2019 dhe raportuar çdo tre-mujor në Ministrinë e Financave. Për vitin 2017 shumë fatura nuk janë likuiduar në afat për arsye të limit të vendosur nga Ministria e Financave në Degën e Thesarit.***

-Bashkia Dropull ka administruar 4 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 5,012,862 lekë, të cilat janë shlyer të gjitha.

Bashkia Dropull, për vitin 2017 ka përfutur investime nga Fondi i Zhvillimi të Rajoneve për tre objektet dhe konkretisht:

1-Qendër Multifunkionale shërbimesh në vlerën 40,282,748 lekë.

2-Unaza Pogon në vlerën 22,175,593 lekë.

Për të cilat janë kryer dhe pagesat në vlerat respektive.

Për vitin 2018

1-Unaza Pogon në vlerën 115,722,303 lekë.

Për të cilin është kryer dhe pagesa brenda vitit 2018.

5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara,

**Mbi faturat e palikuiduara:**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat për të dy vitet është bërë përcaktimi i tyre në vlerë për çdo program, por edhe i detajuar.

Faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” si gjendje në fund të vitit 2018, paraqiten në shumën **2,030,698 lekë**.

Limiti i vendosur nga MFE, ka ndikuar në krijimin e faturave të prapambetura pasi ka pasur fonde për likuidim dhe faturat kanë mbetur pa likuiduar duke shtuar vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc ku për vitin 2017, vlera totale e detyrimeve është 23,512,530 lekë, përfshirë dhe faturat e muajit dhjetor 2017. Janë likuiduar faturat të lindura për arsye limit me vlerë 23,512,530 lekë .

Në vitin 2018 janë 49 fatura që mbajnë data të fundvitit 2017, ndërsa në vitin 2019 fatura që datojnë në fund të vitit 2018 janë 13, të cilat nuk janë likuiduar për arsye limit si dhe faturat e muajit dhjetor që likuidohen në janar të vitit pasardhës, si ujë, energji, postë, ndihma ekonomike, këshilltarët etj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Nga ana e Bashkisë Dropull të gjitha faturat janë regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e Thesarit. Duhet theksuar fakti se detyrimet që përbëhen nga këto fatura është në vlerën 23,512,530 lekë për vitin 2017, që janë likuiduar në vitin 2018, ndërsa vlera 8,104,720 lekë, në vitin 2019 për llogari të vitit 2018.

Faturat e palikuiduara janë likuiduar të gjitha 6/Mujorin e parë të vitit 2019 dhe raportuar çdo tre-mujor në Ministrinë e Financave. Për vitin 2017 shumë fatura nuk janë likuiduar në afat për arsye të limit të vendosur nga Ministria e Financave në Degën e Thesarit. Në total sipas zërave faturat e pa likuiduara paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme e konkretisht për faturat e pa likuiduara për Investimet e kryera, për faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 486 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

#### Gjetje nr.3 Mbi faturat e palikuiduara

**Situata:** -Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2018, Bashkia Dropull ka një detyrim ndaj të tretëve prej 2,030,698 lekë (llogaria 486, furnitor e llogari të lidhura me to). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr.5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 - Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

**Kriteri** Neni 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr.5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr.2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 - Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

**Impakti** Ndikim në buxhetimin pasardhës

**Shkaku** Moslikuidimi i faturave

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi** Nuk ka rekomandim pasi këto fatura janë likuiduar në 6 mujorin e parë të vitit 2019

#### 5/1. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga vendimet gjyqësore, vendimet

Bashkia Dropull ka administruar 4 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 5,012,862 lekë, të cilat janë shlyer të gjitha, sa vijon:

| Nr | Padites | Objekti   | Detyrimi  | Nga kjo, likuiduar |          |           |
|----|---------|---|-----------|--------------------|----------|-----------|
|    |         |   |           | U.Sh Nr            | Datë     | Lekë      |
| 1  | L.B.    | Detyrim i palës së paditur të dëmspërblejë paditësin në shumën 4,624,868 lekë | 4,624,868 | 125                | 01.03.18 | 1,000,000 |
|    |         |   |           | 286                | 31.05.18 | 1,000,000 |
|    |         |   |           | 526                | 27.09.18 | 1,624,868 |
|    |         |   |           | 718                | 27.12.18 | 1,000,000 |
| 2  | S.J.    | Detyrim i Bashkisë Dropull të   | 51,240    | 86                 | 03.03.17 | 51,240    |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

|   |                         |                                      |                  |     |          |                  |
|---|-------------------------|--------------------------------------|------------------|-----|----------|------------------|
|   |                         | lidhë kontratën e qerasë             |                  |     |          |                  |
| 3 | A.Z.                    | Detyrim të kthejë në punë paditësin. | 270,728          | 124 | 01.03.18 | 270,728          |
| 4 | “M...” sh.p.k<br>Tirane | Kthim shume                          | 66,026           | 336 | 02.08.17 | 66,026           |
|   | <b>SHUMA</b>            |                                      | <b>5,012,862</b> |     |          | <b>5,012,862</b> |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

**Gjetje nr.4**

**Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore**

**Situata:** **Bashkia Dropull ka administruar 4 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerën 5,012,862 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

**Kriteri** Pika 62 e udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

**Impakti** Ndikim në buxhetimin pasardhës

**Shkaku** Proceset gjyqësore

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi** Nuk ka rekomandim pasi këto shuma janë likuiduar në 6 mujorin e parë të vitit 2019

**Afati për zbatim**

**B/4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;**

Paketa fiskale, për vitin 2017 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.70, datë 28.12.2016 dhe për vitin 2018 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.55, datë 24.11.2017 dhe për vitin 2019 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.70, datë 23.11.2018 dhe me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.10, datë 20.02.2019.

Nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 53,875 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 51,093 mijë lekë ose 95 %, **me një mos realizim në vlerën 2,782 mijë lekë.**

Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 43,461 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 47,178 mijë lekë ose 108 %, **me një tejkalim në vlerën 3,717 mijë lekë.**

Për 6/mujorin e parë të vitit 2019, të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore gjithsej, nga 22,092 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 31,544 mijë lekë ose 142%, me një tejkalim në vlerën 9,452 mijë lekë.

Nga të dhënat e pasqyrës si më sipër rezulton se plani i të ardhurave nga viti në vit rezulton me rritje, për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 kemi një rritje në vlerën 507 mijë lekë (51,093 mijë lekë - 50,586 mijë lekë) dhe për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017 kemi një rritje në vlerën 3,907 mijë lekë (47,178 mijë lekë - 43,271 mijë lekë).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Në lidhje me auditimin mbi administrimin e aseteve, procedurën e dhënies me qira të aseteve të qëndrueshme (pa tokën bujqësore) në varësi të Bashkisë, menaxhimi i aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike për komunitetin, administrimin e plotë të tyre nga Bashkia në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Në auditimin e kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2017 deri më datën 30.06.2019, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, konstatohet se nga Bashkia Dropull është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullimore për të cilat të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje të nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë me subjektet

#### Gjetje nr.5

#### Debitorët nga sektori i taksave dhe tarifave vendore

**Situata:** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, **në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë** (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtesë në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë).

**Kriteri** Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”,

**Impakti** Ndikim në mungesë në të ardhurat e Bashkisë

**Shkaku** Mosmbledhja e detyrimeve.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi** Sektori i Taksave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, **në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë** (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtesë në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë), bazuar në nenin 70 pika 3 “*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

*a-T'u ridërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.*

*c- Sektori i Taksave, të evidentojnë listat emërore të debitorëve në*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, ku përcaktohet se: Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit familjarë dhe bizneset, në territorin përkatës), të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

**Afati për zbatim** Menjëherë.

Më hollësisht trajtuar në **ANEKS B**, bashkëlidhur këtij materiali.

### C. VLERËSIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.

- 1.1 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 1.2 Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme) ;
- 1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënjesisë;
- 1.4 Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Dropull, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 368/1, datë 28.05.2019, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit (viti 2018) për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të mbyllur më datë 31.12.2017 dhe 31.12.2018.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të risim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

**Objektivat e auditimit:** “Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion”.

**Objektivat specifike të auditimit** ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

**Baza Ligjore:** Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”

-INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

-Në praktikat më të mira të fushës si: (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC, Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve),

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara.;

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik” .;

-VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesmarrje”.

-Udhëzimi nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore , organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” .;

-Udhëzimi i MF nr.8 datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme” .;

**Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:** Përgjegjës i Sektorit të Financës zj.T.P., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar (SNK dhe SKK) dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Përgjegjës i Sektorit të Financës zj.T.P. është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dropull.

Gjetjet më kryesore që u konstatuan në auditimin e pasqyrave financiare dhe në pozicionet e llogarive të përmbledhura paraqiten për sa vijon:

#### Gjetja nr.6 Problematikat e konstatuara në analizimin e llog 202-*Studime e projekte*

##### Situata

Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “*Studime e projekte*”, në bilancin e vitit 2018 paraqitet në vlerën 6,263,032 lekë, ose rritur për vlerën 2,289,278 lekë. Sipas analizës rezulton se në Bashkinë Dropull në 31.12.2018 llogaria 202 paraqet 18 studime dhe kërkime nga të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

cilat:

c. *Gjate vitit 2017 janë shtuar 3 studime me vlerën prej 2,339,280 lekë.*

d. *Gjatë vitit 2018 janë shtuar 4 studime me vlerën prej 3,394,519 lekë.*

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se 28 studime e projektme në vlerën **11,688,221** lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Dropull. Referuar të dhënave të subjektit, ku të gjithë projektet janë vënë në zbatim, kontabilizimi i këtyre vlerave në llog. 202 është i gabuar, pasi vlera e këtyre projekteve duhej të paraqitej në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas objekteve), pasi përfaqëson vlerën e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar.

UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre, si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe te mbylljes se llogarive; kërkesat e nenin 7, 9, 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II.

#### Kriteri:

Pasqyrat financiare të vitit 2018 nuk paraqesin realitetin, kjo si rezultat i pasaktësisë së veprimeve në llog. 202.

#### Impakti:

#### Shkaku:

Mos njohja e situatës në lidhje me projektet e zbatuara.

#### Rëndësia:

**I mesëm.**

#### Rekomandimi:

-Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e projektme*”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, vlerën 11,688,221 lekë.

#### Afati për zbatim

Menjëherë.

#### **Gjetja nr.7 Konstatimi i amortizimit të gabuar të Aktiveve që janë në proces gjatë analizimit të llog 202-*Studime e projektme*.**

Nga verifikimi i llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” për vitin **2018** rezultojnë se **3** studime dhe kërkime në vlerën prej **1,882,999** lekë nuk kanë filluar të vihen në zbatim: -*Studim projektim “Ujësjiellës Selo-Levinë-Krioner” me vlerë 834,999 lekë*; -*Studim projektim “Amfiteatri Sofratikë” me vlerë 528,000 lekë*; -*Studim projektim plani i mbarështimit të pyjeve me vlerë 520,000 lekë*.

Për këto asete që njësia publike ka përlllogaritur norma amortizimi në vlerën prej **282,449** lekë, rezultojnë se, referuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05) përcaktohet qartë se; (*projektet e studimet, kur janë për një aktiv konkret koston e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivit, pra amortizohen (shpërndahen) në totalin e shpenzimeve të ndërtimit të aktivit (situacioni+studimi+projektimi=kosto e plotë e aktivit)*). Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është i gabuar. Kjo procedurë është bërë në

#### Situata



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

kundërrshtim me VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 në pikën nr.40 i cili citon “Amortizimi i një aktivi afatgjatë fillon kur ai është i gatshëm për përdorim (pra aktivet në proces nuk amortizohen) dhe vazhdon deri në amortizimin e plotë të vlerës së amortizueshme ose deri sa ai çregjistrohet, del nga përdorimi..”.

UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre, si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe të mbylljes së llogarive; kërkesat e nenin 7, 9, 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II; Standarti Kombëtar i Kontabilitetit nr.5 (SKK5), pika nr.40.

#### Kriteri

#### Impakti:

#### Shkaku:

#### Rëndësia:

#### Rekomandimi:

Regjistrim i gabuar në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në bilanc të llogarisë 202.

Mos njohja e situatës në lidhje me amortizimin e aktiveve që janë në proces.

**I lartë.**

-Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e projekte*”, në mënyrë që në këtë llogari të mos amortizohen aktivet të cilat rezultojnë në proces dhe nuk janë të përfunduara dhe të merren masa për sistemimin e vlerë së përlllogaritur të amortizimit 282,449 lekë duke kredituar amortizimin e akumuluar dhe debituar koston historike.

#### **Gjetja nr.8 Problematikat në inventarizimin e pronës shtetërore llog.210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarisë 211”Pyje, Plantacione dhe Kullota”.**

Aktivitet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (210 “Toka, troje e terrene”, 211 “Pyje, Plantacione dhe Kullota” 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri , pajisje e vegla pune” , 215 “Mjete transporti”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhornuar pas bashkimit të njësive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra.

Sektori i financës Bashkia Dropull për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë , asetëve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:

-llog.(210)“Toka, troje, terrene” vlera kontabël 198,582 lekë e pa ndryshuar.

-llog.(211)“Pyje, kullota, plantacione” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.

Sektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.)

#### Situata

#### Kriteri

Ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ neni 7 , udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

sektorit publik” sipas pikës 73, 97, 99, 100, 102, 105 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011.

#### **Impakti:**

Në kontabilitet për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj*), asete të cilat nuk janë regjistruar në ZRPP Gjirokastrë në pronësi të njësisë publike Bashkia Dropull.

#### **Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i Ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ neni 7 dhe pikën 105 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “ *Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” sipas pikës 73, 97, 99, 100, 102, 105 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011.

#### **Rëndësia:**

**E lartë.**

#### **Rekomandimi:**

Nga ana e Bashkisë Dropull të merren masa për të azhornuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe inventarizim.

Titullari i njësisë publike Bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e aseteve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të bashkisë, ndërsa nga Sektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Dropull, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre aseteve.

#### **Afati për zbatim**

Menjëherë.

#### **Gjetja nr.9 Përlllogaritje e gabuar e amortizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale gjatë analizimit të llog 215-Mjete transporti dhe llog.218-Inventar ekonomik.**

#### **Situata**

Nga ripërformimi i amortizimit sipas normave të përcaktuara në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore vihet re Llogaria 215 “*Mjete Transporti*” amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 5,557,757 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 6,549,997 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht **992,240 lekë** duke përdorur normë amortizimi 57% dhe jo 20% në kundërshtim me *pikën 36 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore.*

Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 12,634,887 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 14,322,963 lekë duke përdorur normë amortizimi 45% dhe jo 20%, pra janë ngarkuar padrejtësisht **1,668,075 lekë** në kundërshtim me *pikën 36 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore.*

#### **Impakti:**

Rregjistrim i gabuar në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në bilanc të llogarisë 215 “Mjete





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

transporti” dhe llogarisë 218 “Inventar ekonomik”.

**Kriteri**

UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara”.

**Shkaku:**

Përlllogaritje me normat të gabuara ne amortizimin e aktiveve afatgjata materiale duke deformuar informacionin financiar në lidhje me vlerën kontabël neto të paraqitur në bilanc për llog.215 “Mjete transporti” dhe llog.218 “Inventar ekonomik”.

**Rëndësia:**

**I lartë.**

**Rekomandimi:**

-Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 “Mjete transporti” duke e debituar në vlerën **992,240** lekë dhe sistemimin e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” duke e debituar në vlerën **1,668,075** lekë, të shkaktuara nga përlllogaritja e amortizimit me norma të gabuara të cilat kanë deformuar vlerën kontabël neto të tyre.

|   |
|---|
| <b>Gjetja nr.10 Mos pasqyrimi në kontabilitet si Aktive Afatgjata Financiare të pjesëmarrjes në aksione që Bashkia Dropull ka te “Ujësjiellës Kanalizime Dropull” sh.a.</b> |
|---|

Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën 0 lekë. Në Bashkinë Dropull, është organizuar dhe funksionon shoqëria aksionare “Ujësjiellës Kanalizime Dropull” sha., e cila sipas ekstraktit historik është një shoqëri e themeluar sipas statusit të miratuar datë 16.02.2018, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me NIPT L82616601E me kapitalin fillestar 5.000.000 lekë, me aksioner të vetëm Bashkia Dropull me kapital 100%.

**Situata**

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrje të Bashkisë Dropull në “Ujësjiellës Kanalizime Dropull” sh.a në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2018 në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, me urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesmarrje” pika 35.

**Kriteri**

UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” ku specifikohet trajtimi kontabël dhe funksionimi i AAGJ financiare, Urdhri ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesmarrje” pika 35.

**Impakti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në bilanc të llogarisë 26 “Pjesmarrje në kapitalin e vet”.

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” ku specifikohet trajtimi kontabël dhe funksionimi i AAGJ financiare, Urdhri ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

“Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesmarrje” pika 35.

#### **Rëndësia:**

**I mesëm.**

#### **Rekomandimi:**

Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë regjistrimin në kontabilitet të pjesmarrjes në aksione 100% me vlerë kontabël 5,000,000 lekë në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalin e vet”.

**Gjetja nr.11 Gjendja e faturave të palikujduara në fund të periudhave 2017 – 2018, dhe mos deklarimi në fund të periudhave ushtrimore të vitit 2017 - 2018, të faturave të palikujduara në llogarinë 401-408 dhe 467, fatura të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2018 dhe tremujorit të parë 2019, konstatuar kjo nga testet e kryera në likuidimin të këtyre periudhave.**

#### **Situata:**

Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2017 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën **17,113,754 lekë** ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **0 lekë**. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore.

Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Dhjetor 2018, për llogari të vitit 2017 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2017 paraqiten në vlerën 31,016,897 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 17,113,754 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej **13,903,143 lekë** më pak (31,016,897-17,113,754). Bazuar në të dhënat e SIFQ detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2017 në bilanc duhet ti kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej **5,215,750 lekë**. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në dt.31.12.2017 janë në vlerën prej **25,801,147 lekë**, duhet të ishin paraqitur në bilanc të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Paraqitet në bilanc për vitin 2017 në vlerën 0 lekë, Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 25,801,147 lekë.

Duke u bazuar tek udhëzimi i drejtorisë së thesarit mbështetur dhe në udhëzimin nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku specifikohet që detyrimet e prapambetura të raportohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe jo në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Pra shuma prej 25,801,147 lekë përbën tashmë vetëm detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2017.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 25,801,147 lekë.

**Për aktivitetin e vitit 2018,** konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën **2,030,698 lekë** ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **0 lekë**. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Dhjetor 2019, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2012 paraqiten në vlerën 3,350,087 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 2,030,698 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej 1,319,389 lekë më pak (3,350,087-2,030,698). Bazuar në të dhënat e SIFQ detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2018 në bilanc duhet ti kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej 2,309,333 lekë. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në datë 31.12.2018 kanë vlerën prej 1,040,754 lekë, të cilat duhet të ishin paraqitur në bilanc të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”. Paraqitet në bilanc për vitin 2018 në vlerën 0 lekë. Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 1,040,754 lekë.

Duke u bazuar tek udhëzimi i drejtorisë së thesarit mbështetur dhe në udhëzimin nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku specifikohet që detyrimet e prapambetura të raportohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe jo në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Pra shuma prej 1,040,754 lekë përbën tashmë vetëm detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2018.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 1,040,754 lekë.

Mangësitë e mësipërme (mos regjistrim i faturave kreditore), në fund të periudhës ushtrimore si detyrime që Bashkia Dropull ka ndaj subjekteve të ndryshme, bën që pasqyrat financiare të mos paraqesin realitetin e tyre.

#### **Kriteri:**

Me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “*Rregulla të përgjithshme*” kapitulli i parë “*Mbajtja e kontabilitetit*”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” dhe Udhëzimi Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

#### **Impakti:**

Pasqyrat financiare nuk paraqesin realitetin të veprimeve financiare, kjo nga mos pasqyrimi i të gjithë vlerës së faturave të palikjduara në fund të periudhës (kreditorët).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**Shkaku:** Mosveprim i nënpunësit zbatues. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Sektori i Financës të paraqes një material ku të rakordojë me sistemin SIFQ gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën **3,350,087 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave.

Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e palikujduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhave ushtrimore.

#### Gjetja nr.12 Mungesa e dokumentacionit dhe aktit të marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga donatorë të huaj.

##### Situata

Teprica e Granteve kapitale të huaja përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute nga qeveri dhe institucione ndërkombëtare për investime. Në formatin 6 të pasqyrave ku përshkruhen Investimet dhe Burimet e Financimit është e paraqitur vlera 1,207,243 në llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”, ku rezulton se nga ana e Bashkisë Dropull mungon dokumentacioni dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”;

##### Kriteri

UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore” *ku specifikohet trajtimi kontabël dhe funksionimi i AAGJ financiare*, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.

##### Impakti:

Mos regjistrim në kontabilitet i aktivitetit të dhuruar dhe deformim i informacionit financiar.

##### Shkaku:

Mangësia në dokumentacion dhe mos paraqitja e aktit të marrjes në dorëzim të aktivitetit në natyrë të dhuruar nga donatorë të huaj.

##### Rëndësia:

**I mesëm.**

##### Rekomandimi:

Nga Sektorit i Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të vlerës **1,207,243** duke debituar llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”.

#### **OPINIONI I AUDITUESIT:**

##### **Opinion i pakualifikuar (me rezervë):**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; pozicioni financiar, performanca, ndryshimet në kapital, flukset e mjeteve monetare janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit, SNK dhe SKK të përmirësuara.

E gjykojmë të arsyeshme të konstatojmë, se ka probleme për çështje specifike për të cilat duhet të japim një paragraf shpjegues mbi rezervat që kemi.

*Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) me përjashtim të efekteve të çështjeve të trajtuara në opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkisë Dropull më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin, në përputhje me konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

#### **Opinionit i pakualifikuar me rezervë:**

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se menaxhimi i subjektit, mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare nëse atij nuk do t’i vihen në dukje rezervat që kemi për çështje specifike të pazakonta të konstatuara:

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për rezervat në opinion te fakti se nuk jemi dakord për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si vijon:

**-Llogaria 202 “Studime dhe Projektme”** me vlerë në bilancin kontabël për vitin 2018 6,263,032 lekë, konstatohet se disa studime e projektme në vlerën **11,688,221** lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish Komunitat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Dropull dhe nuk janë klasifikuar si Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

-Për vitin **2018** rezulton se **3** studime dhe kërkime në vlerën prej **1,882,999** lekë nuk kanë filluar të vihen në zbatim, Për këto asete ndërkohë që njëzia publike ka përllogaritur norma amortizimi në vlerën prej **282,449** lekë, rezulton se, referuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05) përcaktohet qartë se: (projektet e studimit, kur janë për një aktiv konkret koston e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivitetit, pra amortizohen (shpërndahen) në totalin e shpenzimeve të ndërtimit të aktivitetit (situacioni+studimi+projektimi=kosto e plotë e aktivitetit). Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është i gabuar.

**-Llogaria 215 “Mjete Transporti”** amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 5,557,757 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 6,549,997 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht **992,240 lekë** në kundërshtim me pikën 36 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 pika nr.40

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 12,634,887 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 14,322,963 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht **1,668,075 lekë**, në kundërshtim me pikën 36 të udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË  
PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

*Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 pika nr.40*

**-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”Aktivet Financiare** paraqitet në vlerën zero në bilancin kontabël 2018 edhe pse Bashkia Dropull zotëron 100% aksione në pjesëmarrje tek “Ujësjellës Kanalizime Dropull “ sh.a me vlerë **5,000,000 lekë** , kjo pjesëmarrje në kapitalin e vet në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2018 në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”, urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35.

**- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në bilanc për vitin 2018 në vlerën 0 lekë, Nga analiza e mësipërme duhet të ishte në vlerën 1,040,754 lekë.

Duke u bazuar tek udhëzimi i drejtorisë së thesarit mbështetur dhe në udhëzimin nr.8 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku specifikohet që detyrimet e prapambetura të raportohen në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe jo në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”. Pra shuma prej 1,040,754 lekë përbën tashmë vetëm detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2018.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 1,040,754 lekë.

*Kjo procedurë mospasqyrimi në Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” të Bilancit Kontabël të vlerës së detyrimeve të prapambetura të cilat janë me vlerë kontabël 1,040,754 lekë është në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”.*

**-Aktivet të cilat janë detajuar me rregjistra kontabël** (210 “Toka, troje e terrene” , 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “ Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instaime teknike, makineri , pajisje e vegla pune” , 215 “Mjete transporti”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhornuar pas bashkimit të njesive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra. *Nuk është hartuar regjistër kontabël ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit , vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim, si dhe identifikohet problematika për moskryerjen e inventarizimit vjetor të tyre në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*

**- (Llog. 106) Teprica e Granteve kapitale të huaja**

Teprica e Granteve kapitale të huaja përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute nga qeveri dhe institucione ndërkombëtare për investime. Në formatin 6 të pasqyrave ku përshkruhen Investimet dhe Burimet e Financimit është e përcaktuar vlera 1,207,243 në llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”, dhe nga ana e Bashkisë Dropull mungon dokumentacioni dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj.

*Për këtë mangësi në dokumentacion në Llog.106 “Teprica e Granteve kapitale të huaja” të Bilancit Kontabël të aktivitetit të dhuruar me vlerë kontabël 1,207,243 lek rezulton në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”., dhe me udhëzimin e MF nr.8 datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”.*

Më hollësisht çështjet janë trajtuar në **ANEKS C**, pjesë e këtij materiali.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

**D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017.**

1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;
2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);
5. Opinion mbi prokurimin e fondeve në nivel institucional shoqëruar me një tabelë në lidhje me procedurat e prokurimit publik.

Nga ana e AK, Bashkia Dropull për vitet objekt auditimi janë zhvilluar 26 procedura prokurimi me fond limit 211,675,995 lekë, për të cilat është ofertuar me diferencë nga fondi limit në shumën 7,212,091 lekë.

Nga këto procedura prokurimi nga ana e KLSH janë audituar 91,6 % e fondit limit limit të prokuruar ose 16 procedura prokurimi me vlerë 193,845,329 lekë, e përcaktuar më hollësisht sipas viteve dhe llojit të procedurës së prokurimit sipas tabelave sa më poshtë vijon:

Tabela mbi fondet e prokuruarat e të audituara në Bashkinë Dropull, për periudhën objekt auditimi.

| Objekti i prokurimit | Fondi limit           |                      | Në %<br>audituar nga<br>KLSH | OE        |           | Oferta<br>Ekonomike | Diferenca        |
|----------------------|-----------------------|----------------------|------------------------------|-----------|-----------|---------------------|------------------|
|                      | i prokuruar<br>nga AK | audituar nga<br>KLSH |                              | Σ         | S`kual,   |                     |                  |
| Viti 2017            | 145,558,971           | 136,177,809          | 93.6                         | 30        | 11        | 141,287,485         | 4,251,486        |
| Viti 2018            | 35,787,539            | 27,338,035           | 76.4                         | 31        | 11        | 34,699,993          | 950,226          |
| 6 mujori<br>2019     | 30,329,485            | 30,329,485           | 100                          | 8         | 3         | 28,319,106          | 2,010,379        |
| <b>Totali</b>        | <b>211,675,995</b>    | <b>193,845,329</b>   | <b>91.6</b>                  | <b>69</b> | <b>25</b> | <b>204,306,584</b>  | <b>7,212,091</b> |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

Tabela mbi fondet e prokuruarat e të audituara në Bashkinë Dropull, në total sipas llojit të procedurës së prokurimit.

| Sipas procedurave të prokurimit | Statusi   | Numër procedurash | Fondi limit | OE |          | Vlera e fituar | Diferenca |
|---------------------------------|-----------|-------------------|-------------|----|----------|----------------|-----------|
|                                 |           |                   |             | Σ  | S`kualif |                |           |
| Kërkesë për propozim            | Zhvilluar | 21                | 52,722,879  | 51 | 16       | 50,101,669     | 2,463,890 |
|                                 | Audituar  | 11                | 34,892,213  | 23 | 7        | 33,487,919     | 1,404,294 |
|                                 | %         |                   | 66          |    |          |                |           |
| E hapur                         | Zhvilluar | 3                 | 152,664,116 | 10 | 4        | 148,285,435    | 4,378,681 |
|                                 | Audituar  | 3                 | 152,664,116 | 10 | 6        | 148,285,435    | 4,378,681 |
|                                 | %         |                   | 100         |    |          |                |           |
| Sherbim konsulence              | Zhvilluar | 1                 | 3,509,000   | 5  | 3        | 3,149,000      | 360,000   |
|                                 | Audituar  | 1                 | 3,509,000   | 5  | 3        | 3,149,000      | 360,000   |
|                                 | %         |                   | 100         |    |          |                |           |
| Negocim pa shpallje             | Zhvilluar | 1                 | 2,780,000   | 3  | 2        | 2,770,480      | 9,520     |
|                                 | Audituar  | 1                 | 2,780,000   | 3  | 2        | 2,770,480      | 9,520     |
|                                 | %         |                   | 100         |    |          |                |           |
| Në total                        | Zhvilluar | 26                | 211,675,995 | 69 | 25       | 204,306,584    | 7,212,091 |
|                                 | Audituar  | 16                | 193,845,329 | 41 | 18       | 187,692,834    | 6,152,495 |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

| Sipas procedurave të prokurimit | Statusi | Numër procedurash | Fondi limit | OE |          | Vlera e fituar | Diferenca |
|---------------------------------|---------|-------------------|-------------|----|----------|----------------|-----------|
|                                 |         |                   |             | Σ  | S`kualif |                |           |
|                                 | %       |                   | <b>91.6</b> |    |          |                |           |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

|                          | Kërkesë për propozim |            |             | E hapur     |             |            | Sherbim konsulence |           |            | Negocim pa shpallje |           |            |
|--------------------------|----------------------|------------|-------------|-------------|-------------|------------|--------------------|-----------|------------|---------------------|-----------|------------|
|                          | Gjithsej             | Audituar   | %           | Gjithsej    | Audituar    | %          | Gjithsej           | Audituar  | %          | Gjithsej            | Audituar  | %          |
| <b>Numër procedurash</b> | 21                   | 11         | <b>52.4</b> | 3           | 3           | <b>100</b> | 1                  | 1         | <b>100</b> | 1                   | 1         | <b>100</b> |
| <b>Fondi limit</b>       | 52,722,879           | 34,892,213 | <b>66.2</b> | 152,664,116 | 152,664,116 | <b>100</b> | 3,509,000          | 3,509,000 | <b>100</b> | 2,780,000           | 2,780,000 | <b>100</b> |
| <b>Vlera fituar</b>      | 50,101,669           | 33,487,919 | <b>66.9</b> | 148,285,435 | 148,285,435 | <b>100</b> | 3,149,000          | 3,149,000 | <b>100</b> | 2,770,480           | 2,770,480 | <b>100</b> |

*Baza e të dhënave: Bashkia Dropull*

**C/3- Realizimi i investimeve.**

Nga auditimi i periudhës objekt auditimi ka rezultuar se urdhrat e prokurimit janë të saktë dhe në vlerë të plotë në sistemin e thesari përpara fillimit të procedurës dhe brenda afateve të përcaktuar ne ligj.

Sipas viteve realizimi i investimeve paraqitet sa vijon:

**Për vitin 2017** mosrealizimi për i investime, është në shumën **14.224** mijë lekë ose në masën **31.7%**, ku nga auditimi rezultoi se arsyeja e mosrealizimit është si rezultat i:

**Lidhjes së kontratave në fund të vitit buxhetor per objektet:**

- 1-“Rikonstruksione ne rrjetin e ujesjellesit”
- 2-“Kanali Ushqyes Pepel+200 m3”

**Kryesisht nga vendosja e limitit nga Ministria e Financave per objektet:**

- 1-“Rikonstruksioni I rrugeve ne Njesine Administrative Pogon”
- 2-“Projektim per project zbatimin e Ujesjellesit Manxifa”
- 3-“Rikonstruksion rruge te brendshme Dropull”

Per objektin”Mbi ndertimin e rrjetit rrugor “Unaza Pogonit”, faza I kontrata ze vleren 137.897.895 plani per 2017 ishte 22.175.593 leke.

Më hollësisht të dhënat paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

*000lekë*

| Nr. | Emërtimi i objektit   | Plan          | Fakt          | Dif. + -       | % e mosrealizimit |
|-----|---|---------------|---------------|----------------|-------------------|
| 1   | “Depo uji V=150 m3,fshati Kakavie”                          | 2.553         | 2.553         | 0              | 0                 |
| 2   | “Rikonstruksioni I rrugeve ne Njesine Administrative Pogon” | 7.805         | 3.580         | -4.225         | 54                |
| 3   | “Projektim per project zbatimin e Ujesjellesit Manxifa”     | 3.778         | 2.267         | -1.511         | 40                |
| 4   | “Rikonstruksion rruge te brendshme Dropull”                 | 2.781         | 0             | -2.781         | 100               |
| 5   | “Kanali Ushqyes Pepel+200 m3”                               | 3.672         | 0             | -3.672         | 100               |
| 6   | “Rikonstruksione ne rrjetin e ujesjellesit”                 | 2.036         | 0             | -2.035         | 100               |
| 7   | Mbi ndertimin e rrjetit rrugor “Unaza Pogonit”faza I        | 22.175        | 22.175        | 0              | 0                 |
|     | <b>TOTALI</b>   | <b>44.800</b> | <b>30.575</b> | <b>-14.224</b> | <b>31.7</b>       |

*Trajtuar më hollësisht në Pasqyrën nr. 8 “Planifikimit dhe realizimit të investimeve viti 2017”*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Për vitin 2018, nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Dropull rezultoi se për vitin 2018 mosrealizimi është në vlerën 1.890 mije leke ose 7.3%, e ardhur kryesisht nga:

–Lidhjes së kontratave në fund të vitit buxhetor për objektet:

a- Zgjerimi i varezave të fshatit Grapsh

- Limit i vendosur nga Ministria e Financës kryesisht në objektet

a- Depo Uji Skore dhe lidhja me rrjetin e ujit

b- Depo Uji Koshovice dhe lidhja me rrjetin e ujit

Më hollësisht të dhënat paraqiten në tabelën sa më poshtë vijon:

| në 000/lekë |   |               |               |               |                  |
|-------------|---|---------------|---------------|---------------|------------------|
| Nr.         | Emërtimi i objektit   | Plan          | Fakt          | Dif, + -      | % mos realizimit |
| 1           | Studim projektim :Rikonstruksion i ujesjellesit te fshatrave Selo-Llovine-Krioner-Sotire" | 835           | 835           | 0             | 0                |
| 2           | Depo Uji Skore dhe lidhja me rrjetin e ujit   | 2.398         | 2.081         | -317          | 13.2             |
| 3           | Rikonstruksion i rrugeve te brendshme te fshatrave te Bashkise                            | 15.185        | 15.185        | 0             | 0                |
| 4           | Depo Uji Koshovice dhe lidhja me rrjetin e ujit   | 2.915         | 2.285         | -630          | 21.6             |
| 5           | Rikonstruksion catie Vatra e Kultures Gline   | 1.076         | 1.076         | 0             | 0                |
| 6           | Zgjerimi i varezave te fshatit Grapsh   | 943           | 0             | -943          | 100              |
| 7           | Mobilimi i brendshem i zyrave   | 2.398         | 2.398         | 0             | 0                |
|             | <b>TOTALI</b>   | <b>25.752</b> | <b>23.860</b> | <b>-1.890</b> | <b>7.3</b>       |

*Trajtuar më hollësisht në Pasqyrën nr. 12 “Planifikimit dhe realizimit të investimeve viti 2018”*

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, rezultoi se në tre raste procedurash me vlerë të fondit limit nën materialitetin e përcaktuar, sa vijon:

Kontrata me objekt “**Depo uji Skore dhe lidhja me rrjetin e ujit**”:

|  |  |   |
|--|--|---|
| Urdhër prokurimi nr.950/1 Prot, datë 25.05.2018. | NJHDT<br>A.P.                                  | KVO me urdhërin nr. 951/1, datë 25.05.2018.                     |
| Fondi limit 2.083.308 lekë pa tvsh               | A.T.   | T.P. - kryetar  |
| Procedura e prokurimit: Kerkese per propozim     | J.Q.   | L.K. - anëtar<br>E.L. - anëtar                                  |
| Burimi i Financimit: Buxheti i bashkise          | Fitues, OE "T..."shpk                          | Vlera fituese 1.998.250 lekë pa tvsh dhe 2.397.900 leke me tvsh |
| Datë e hapjes 13.06.2018                         | Diferenca nga fondi limit 85,058 lekë pa tvsh. | Kontrata nr.1240 Prot. datë 12.07.2018                          |
| Marrin pjesë 2 OE<br>S`kualifikuar 1 OE          | Miratimi i procedurës date 09.07.2018          | Vlera e kontratës : 2.397.900 leke me tvsh                      |
| Titullar i AK – A.D.                             |  |   |

Kontrata me objekt “**Restaurimi i kanalit vaditës Pepel Vrisera Jergucat, viti 2018**”.

|                                  |  |  |
|----------------------------------|--|--|
| Urdhër prokurimi 756, 24.04.2018 | NJHDT 756, 24.04.2018<br>A.P. - Jurist | KVO 757, 24.04.2018<br>N.B.            |
| Fondi limit 3,166,329 lekë       | A.T.                                   | T.P.                                   |
| Procedura “kërkesë për propozim” | J.Q.                                   | L.K.                                   |
| Datë hapje: 14.05.18             | OE fitues “T...”shpk                   | Miratimi vendimi nr.1, datë 23.05.2018 |



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

|                          |   |   |
|--------------------------|---|---|
| <b>Marrin pjesë 1 OE</b> | <b>Vlera fituese 2,805,400 lekë</b>           | <b>Kontrata nr.966, datë 28.05.18.</b>          |
| <b>Kualifikuar 1 OE</b>  | <b>Diferenca nga fondi limit 360,929 lekë</b> | <b>Vlera e kontratës 3,336,480 lekë me tvsh</b> |
| <b>TAK A.D.</b>          |   |   |

Kontrata me objekt **“Depo uji Koshovicë dhe lidhja me depon e ujit, viti 2018”.**

|  |  |   |
|--|--|---|
| <b>Urdhër prokurimi 9184, 24.05.2018</b> | <b>NJHDT 9184/1, 24.05.2018</b>              | <b>KVO 9491/1, 24.05.17</b>                     |
| <b>Fondi limit 2,498,139 lekë</b>        | A.P. - Jurist                                | T.P.  |
| <b>Procedura “kërkesë për propozim”</b>  | A.T.   | L.K.  |
|  | J.Q.   | E.L.  |
| <b>Datë hapje: 19.06.18</b>              | <b>OE fitues “T...”shpk</b>                  | <b>Miratimi vendimi nr.1, datë 02.07.2018</b>   |
| <b>Marrin pjesë 1 OE</b>                 | <b>Vlera fituese 2,449,700 lekë</b>          | <b>Kontrata nr.1218, datë 10.07.18.</b>         |
| <b>Kualifikuar 1 OE</b>                  | <b>Diferenca nga fondi limit 48,439 lekë</b> | <b>Vlera e kontratës 2,915,640 lekë me tvsh</b> |
| <b>TAK A.D.</b>                          | <b>Mbikëqyrësi i punimeve: “G...” shpk</b>   |   |

Rezultoi se duhet të ishin anuluar pasi OE fitues nuk plotësonte kushtin për eskavator me zinxhir por e kishte paraqitur me goma.

Ndërsa në 7 procedura kërkesë për propozim me vlerë të fondit limit nën materialitetin e përcaktuar është kërkuar nga NJHDT që drejtuesi teknik të qëndrojë gjatë gjithë kohës në kantier, në një kohë që vepra është nën 30 milion lekë, kërkesë e përcaktuar në kundërshtim me kreun I, pika 2.1 të UKM nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit, ku parashikohet se për punime deri në 30 milion lekë nuk është e detyrueshme qëndrimi i drejtuesit teknik në kantier gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Më hollësisht auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit është trajtuar në **ANEKS D**, bashkëlidhur materialit.

**D/4. Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve;**

Nga grupi i auditimit u audituan tre kontrata të zbatimit të punimeve të ndërtimit e konkretisht:

| Nr. | Objekti i kontratës   | Kontraktuesi                | Vlera e kontratës | Dëmi ekonomik | Ne % kundrejt totalit | Fonde pa efektivitet. | Ne % kundrejt totalit |
|-----|---|-----------------------------|-------------------|---------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| 1   | “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”                                     | “E...” shpk & “4 A...” shpk | 137,897,895       | 1,854,605     | 1.3                   |                       |                       |
| 2   | “Qender multi funksionale shërbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull” | “A...” shpk                 | 85,316,927        | 617,500       | 0.7                   |                       |                       |





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

|   |  |             |                    |                  |            |                  |             |
|---|--|-------------|--------------------|------------------|------------|------------------|-------------|
| 3 | “Ujësjetllësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës” | “A...” shpk | 68,995,558         | 947,400          | 1.4        | 4,595,323        | 6,66        |
|   | <b>Totali</b>  |             | <b>292,210,380</b> | <b>3,419,505</b> | <b>1.2</b> | <b>4,595,323</b> | <b>1.57</b> |

Mangësitë e konstatuara nga auditimi i këtyre procedurave paraqitet si vijon:

**Gjetja nr. 13 Objekti prokurimit: “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I” Bashkia Dropull.**

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, Bashkia Dropull, nga zbatuesi i punimeve Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “E... & 4 A...” SHPK Tiranë, për zërat e punimeve: Shtresë çakulli t=15 cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri; Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm, me makineri, sipas kontratës nr. 1198 prot datë 20.09.2017 me vlerë 137,897,895 lekë me TVSH.

|                     |  |
|---------------------|--|
| <b>Situata:</b>     | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:<br>-Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve: Shtresë çakulli t=15 cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri; Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm, me makineri, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve:<br>Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>1,854,605 lekë pa TVSH.</b> |
| <b>Kriteri:</b>     | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2.<br>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1319 prot, datë 10.10.2017.  |
| <b>Impakti:</b>     | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dropull.   |
| <b>Shkaku:</b>      | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.   |
| <b>Rëndësia:</b>    | <b>E lartë.</b>  |
| <b>Rekomandime:</b> | Nga Bashkia Dropull, të merren masa për kompensimin e vlerës prej <b>1,854,605 lekë pa TVSH</b> për volumet e punimeve të pakryera nga BOE “E... & 4 A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1198 prot datë 20.09.2017, me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.  |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**Vlera prej 1,854,605 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dropull.**

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V.M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe Z. S.B., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.*

**Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të observacionit të bërë nga zbatuesi i punimeve BOE “E... & 4 A...” SHPK, të ardhura me shkresën nr. 402/1, datë 03.09.2019 dhe të protokolluara në KLSH me nr.368/4, datë 09.09.19.**

përfaqësuar nga OE “E...” SHPK me përfaqësues Z. A.I., përcjellë në KLSH në datë 26.08.2019, mbi Akt-Konstatimin Nr. 8, datë 09.08.2019 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:

**a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

Sipërmaësi i punimeve, pretendon se:

1. Zëri “Germim shkemb i fortë, sek i lirë, me mina të vogla, me ekskavator 1 m<sup>3</sup> + transport” në volumin prej 480 m<sup>3</sup> është realizuar në seksioni 0+640 m deri në seksionin 0+760 m, në volume shkëmbore për zgjerimin e rrugës dhe vendosje në siguri të saj nga shkëmbinj mbi shpate dhe se ka qenë e nevojshme yë bëheshin shpërthime me mina të vogla për fraksionimin e materialit.

2. Sipërmarrësi i punimeve pretendon se zërat e punimeve: Shtresë çakëlli t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri kanë sipërfaqen 1939 m<sup>2</sup> dhe jo 1500 m<sup>2</sup> siç është llogaritur nga grupi i auditimit.

**b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

1. Nisur nga argumenti i paraqitur në observacion për zërin e punimeve “Germim shkemb i fortë, sek i lirë, me mina të vogla, me ekskavator 1 m<sup>3</sup> + transport” merr në konsideratë argumentet e paraqitura mbi realizimin e këtij zëri dhe zbret vlerën prej 488,640 lekë si dëm ekonomik, rekomandon që realizimi i këtij zëri të pasqyrohet në librezën e masa që ndodhet në dosjen teknike pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull. Mos plotësimi i librezës së masave është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”, në kundërshtim me kushtet e kontratës, ku citon se: “*Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit si dhe destinacionin e objektit. Ai është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*”. Plotësimi i librezës së masave pranë Bashkisë Dropull duhet të behet në rrugë zyrtare me protokoll.

2. Nisur nga argumenti i paraqitur në observacion për zërat e punimeve: Shtresë çakëlli t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri” observacioni nuk merret në konsideratë sepse këto shtresa kanë sipërfaqen 1500 m<sup>2</sup> dhe jo 1939 m<sup>2</sup> siç pretendoni Ju. Në fakt, argumentet e paraqitura në observacion nuk përputhen me projektin e azhurnuar dhe nga matja në autocad rezultojnë se



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

shtresat tek sheshi kanë sipërfaqen 1500 m<sup>2</sup>. Kjo problematikë u konstatua edhe nga auditimi i zbatimit të punimeve në objekt.

*Më hollësisht është trajtuar në ANEKS D/4/1, bashkëlidhur materialit.*

#### **Gjetja nr. 14 Objekti prokurimit: “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull”.**

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull”, nga zbatuesi i punimeve shoqëria “A...” SHPK, Tiranë, për zërat e punimeve: Zëri 1 (2.426 ) Transport të materialeve të prishura (mbeturina); Zëri 8(2.166). F.V Hekur betoni periodik, sipas kontratës nr. 875/1 prot datë 26.09.2016, me vlerë 85,316,927.31 lekë me TVSH.

|                     |   |
|---------------------|---|
| <b>Situata:</b>     | <p>Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:</p> <p>-Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve: Zëri 1 (2.426 ) Transport të materialeve të prishura (mbeturina); Zëri 8(2.166). F.V Hekur betoni periodik, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve:</p> <p>Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>617,500 lekë pa TVSH.</b></p> |
| <b>Kriteri:</b>     | <p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li><li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.2.</li><li>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë 10.10.2017.</li></ul>  |
| <b>Impakti:</b>     | <p>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dropull.</p>   |
| <b>Shkaku:</b>      | <p>Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.</p>   |
| <b>Rëndësia:</b>    | <p><b>E lartë.</b></p>  |
| <b>Rekomandime:</b> | <p>Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>617,500 lekë pa TVSH</b> nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 875/1/1 prot., datë 26.09.2016 me objekt “<i>Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull</i>”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.</p>   |



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**Vlera prej 617,500 lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dropull.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A.D., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe Znj. N.M., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të observacionit të bërë **Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të observacionit të bërë nga zbatuesi i punimeve BOE “E... & 4 A...” SHPK, të ardhura me shkresën nr. 402/1, datë 03.09.2019 dhe të protokolluara në KLSH me nr.368/4, datë 09.09.19.**

nga mbikëqyrësi i punimeve “A...” SHPK, përfaqësuar nga Z. A.D., përcjellë në KLSH në datë 26.08.2019 dhe nr. prot. 1077, mbi Akt-Konstatimin datë 09.08.2019 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:

#### **a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

Mbikëqyrësi i punimeve, pretendon se:

**1.** Përsa i përket zërit “Transport të materialeve të prishura (mbeturina)” sasia në librezën e masave dhe e situacionuar në situacionin përfundimtar është e saktë. Duke ju referuar zërit sipas manualit për punimet e ndërtimit, është parashikuar nga projektuesi në preventivin e kontratës me distancë deri në 5 km. Por nga ana e AK është përcaktuar vend depozitimi me distancë 12 km.

**2.** Përsa i përket zërit “Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III”

Mbikëqyrësi sqaron se duke ju referuar librezës së masave, sasia e situacionuar përputhet me librezën e masave sepse nuk është marrë parasysh germimi për trarët sipas aksit 4-4 dhe 5-5. Kjo problematikë nuk qëndron dhe duhet të konsiderohet si punim i kryer.

**3.** Përsa i përket zërit “F.V Hekur betoni periodik” m bikëqyrësi sqaron se diferenca e llogaritur nga grupi i auditimit nuk qëndron, sepse nëlibrezën e masave nga mbledhja e shumave ka njëdiferencë prej 283.92 kg dhe diferenca tjetër prej 4,931.29 kg sasi që i përket soletës në kuotën  $\pm 0.00$  nuk është marrë parasysh nga audituesit.

#### **b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

**1.** Nisur nga argumenti i paraqitur për zërin e punimeve “Transport të materialeve të prishura (mbeturina)” grupi i auditimit nuk merr në konsideratë observacionin sepse, ndryshimi i distancës së transportit duhej të miratohej me procedurë dhe të trajtohej si zë i ri punimi me vlerë më të lartë, gjithashtu i njëjti zë punimi nuk mund të paguhej dy herë konkretisht, si zë më vete dhe si nënzë punimi.

**2.** Nisur nga argumenti i paraqitur për zërin e punimeve: Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III” observacioni merret në konsideratë duke zbritur vlerën prej 9,937 lekë si dëm ekonomik, sepse observacioni është shoqëruar me shpjegime në librezën e masave.

**3.** Nisur nga argumenti i paraqitur për realizimin e zërit të punimeve “F.V Hekur betoni periodik” grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin sepse:

- **Së pari**, në kushtet kur projekti i zbatimit me objekt: “Qender multi funksionale sherbimesh (sistemim i një godine egzistuese) për Bashkinë Dropull” nuk ka pësuar ndryshime nga pikpamja konstruktive, nga projektuesi “D...” sh.p.k., nuk ka asnjë arsye të shtohet sasia e hekurit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

- **Së dyti**, rritja e sasisë së hekurit nga 58.5866 ton sipas projekt-preventivit bazë në sasinë 63.8 ton hekur, nuk është argumentuar dhe miratuar në procesverbalin e volumeve që shtohen të mbajtur me datë 15.05.2017 dhe gjithashtu në proces verbalin e përdorimit të fondit rezervë të mbajtur me datë 18.05.2017 për 8 (tetë) zëra punimesh me vlerë 2,804,715.2 lekë pa TVSH(ku zëri i hekurit nuk rezulton).

**Më hollësisht janë trajtuar në ANEKS D/4/2**

**Gjetja nr. 15 dhe 16 Kontrata e zbatimit të punimeve të objektit “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull.**

|                                      |  |
|--------------------------------------|--|
| <b>Titulli i gjetjes 15 &amp; 16</b> | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull, nga zbatuesi i punimeve OE “A...” SHPK, për zërat e punimeve 1.28, 2.7 dhe 3.8.   |
| <b>Situata:</b>                      | Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:<br>-Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve “Rrethimi i kaptazhit me tel gabionash L=160 ml” dhe “Gërmim për kanale me makineri”, për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;<br>- Është konstatuar gjithashtu, se është amenduar afati i përfundimit të kontratës me 90 ditë, nga të cilat vetëm 32 ditë janë të argumentuara teknikisht dhe për pasojë, duke qenë se punimet kanë përfunduar 66 ditë pas afatit kontraktual të punimeve, Autoriteti Kontraktor duhet të kishte vendosur penalitete për 34 ditë vonesa, në zbatim të nenit 34, pika, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”. |
| <b>Kriteri:</b>                      | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.<br>- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1523 prot datë 29.12.2016.<br>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1830/1, datë 29.12.2016.<br>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve.   |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b>               | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Dropull.   |
| <b>Shkaku:</b>                       | Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.   |
| <b>Rëndësia:</b>                     | I lartë.   |
| <b>Rekomandime:</b>                  | Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 991,525 lekë pa tvsh nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1523 prot datë 29.12.2016 me   |





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

objekt “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu, Bashkia Dropull të marrë masa që të argumentojë teknikisht amendamntet për shtyrjen e përfundimit të punimeve, me qëllim vënien në kohë në efikasitet të objekteve me ndikim në jetën e banorëve të zonës.

***Vlera prej 947,400 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Dropull. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

- 1) Z. A.K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- 2) Znj. N.M. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

***Vlera prej 4,595,323 lekë, e cila ka ardhur për shkak të amendimit pa argument teknik të afatit të përfundimit të punimeve, përbën mungesë të ardhurash nga penalitetet në Bashkinë Dropull dhe ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor.***

Për sa sipër, është paraqitur observacioni i ardhur nga shoqëria “I...”, të ardhura me shkresën nr. 402/1, datë 03.09.2019 dhe të protokolluara në KLSH me nr.368/4, datë 09.09.19, në të cilin citohet:

1.Referuar **Zërit 1.28 Rrethim i kaptazhit me tel gabionash H=2.0m dhe L=160ml** nga verifikimi i grupit te auditimit rezulton 155ml.

*Ky konstatim nuk qëndron, pasi në përfundim të punimeve, nga matjet e kryera ëe fakt ka rezultuar sipërfaqe totale 320 m<sup>2</sup>. Në kaptazh ka patur dëmtim të rrethimit siç paraqitet edhe në foton e mëposhtme.*

2.Referuar **Zerit 2.7 Germim per kanale me makineri** nga konstatimi i grupit të auditimit se volumi 4517 m<sup>3</sup>, për rrugë ndihmëse në krahë të linjës së ujësjellësit nuk duhet të ishte situacionuar, pasi sipas Udhëzimit Nr.2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe Strukturën e Kostos së Punimeve të Ndërtimit”, Kreu II, Pika B.6, ky punim përfshihet tek shpenzimet e përgjithshme.

*Për sa më sipër, rruga e hapur është rrugë e përhershme që i shërben linjës së ujësjellësit. Hapja e rrugës në faqen e kodrës ka qenë e domosdoshme dhe duhet të ishte përfshirë në preventivin e punimeve bashkë me hapjen e kanalit. Në mungesë të volumit në preventiv është rënë dakort me Autoritetin Kontraktor që të rakordohet në situacionin përfundimtar dhe fondit rezervë. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me rrugë të përkohëshme, siç parashikon udhëzimi i mësipërm, por me rrugë të përhershme.*

3.Referuar **Zerit 3.8 Hidroizolim tubi me dy duar bitum** nga konstatimi i grupit te auditimit se hidroizolimi i tubit brenda pusetes duhet të zbritet pasi hidroizolimi përfshihet te pjesa teknologjike.

*Për sa më sipër, Ju bëjmë me dije se tubi është hidroizoluar i gjithi dhe pusetat janë ndërtuar më vone bashkë me montimin e rakorderive. Për këtë arsye mendojmë se konstatimi i grupit të auditimit nuk qëndron pasi ky proces është realizuar.*

#### **Opinion i grupit ta auditimit:**

Përsa observohet për këtë pikë, sqarojmë si më poshtë:

1. Argumenti i paraqitur për zërin “Rrethim i kaptazhit me tel gabionash H=2.0m dhe L=160ml”, merret në konsideratë vetëm për gjatësinë e rrethimit dhe nuk merret në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

konsideratë për lartësinë e rrethimit. Nga rillogaritja, diferenca e këtij zëri është 16 m<sup>2</sup> (160 ml x 0.1 m diferenca e lartësisë) dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

2. Argumenti i paraqitur për zërin “Gërmim për kanale me makineri” nuk është bindës. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, ky zë pune nuk është ai i pretenduar në observacion, por për rrugën e realizuar për shkak të ndërtimit të ujësjellësit. Kjo rrugë, nëse duhej situacionuar, duhet të ishte e përfshirë si zë më vete, nëse do të ishte parë e domosdoshme nga projektuesi. Nga ana tjetër në dosje nuk administrohet asnjë dokument që të tregojë se situacionimi i këtij volumi është bërë në dakordësi me AK dhe nga verifikimi në terren kjo nuk është rrugë e përhershme. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

3. Argumenti i paraqitur për zërin “Hidroizolim tubi me dy duar bitum”, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në dëmin ekonomik të paraqitur në tabelën përmbledhëse.

Në lidhje me penaltetin e munguar, është paraqitur observacioni nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit A.P. (jurist), A.T. (Ing) dhe A.K. (Specialist), të ardhura me shkresën nr. 402/1, datë 03.09.2019 dhe të protokolluara në KLSH me nr.368/4, datë 09.09.19, në të cilin citohet:

Në ANEKSIN D/4/3, nga kontrolli që është kryer në dosjen teknike është gjetur amendament kontrata që është bërë nga palët, e cila ka shtyrë afatin e punimeve me 90 ditë. Në projekt raportin e ardhur në Bashkinë Dropull është lënë detyrë të argumentojmë teknikisht afatin e shtyrjes së kontratës.

Në Bashkinë Dropull është bërë një kërkesë nga OE A... sh.p.k për shtyrje të afatit të punimeve, shkresë e cila mban datën 21-04-2017 dhe nr prot 23. Argumenti është se, në muajin Janar kanë qenë temperaturat nën 0 gradë dhe se kanë hasur problematika të vazhdueshme me shpronësimet.

Nga ana e AK është marrë kërkesa e OE A... sh.p.k dhe është shqyrtuar. Është bërë amendament kontrata e cila mban datën 25-4-2017 dhe nr prot 508/1, pra, argumentimi në ANEKS D/4/3 se nuk ka nr prot amendament kontrata nuk qëndron nga ana e KLSH. Për sa i përket argumentimit të OE A... sh.p.k në lidhje me shpronësimet, ju bëjmë me dije se, në periudhën që kryheshin punimet në fushën e Dropullit, fshatarët të trembur nga makinerit e rënda që punonin për hapjen e kanaleve për shtrimin e tubacionit shkonin dhe kërkonin llogari të punëtorët se çfarë ishte duke ndodhur dhe se pse nuk janë lajmëruar dhe në raste ekstreme arritën deri në konflikte dhe si rrjedhojë këto situata sollën edhe ndalimin e punimeve. Sqarimin më pas me banorët e Bashkisë Dropull e ka bërë Bashkia, qetësimin e situatës e ka bërë Bashkia, pasi ky tubacion përshkonte një gjatësi të konsiderueshme në fushën e Dropullit.

Në ANEKSIN D/4/3 thuhet se nga dokumentacioni përkatës rezulton se punimet kanë filluar në datën 29-12-2016 dhe kanë përfunduar 04-07-2017, ose 66 ditë pas afatit kontraktual, por brenda afatit të shtyrë me amendament kontrate. Ky argumentim është në vetvete kontradiktor dhe si i tillë nuk duhet të qëndrojë. Si rrjedhojë nuk mund që të kërkosh dëmet e likujdueshme për vonesën e mbarimit të punimeve, kur punimet do të mbarojnë në datën 30-07-2017 dhe OE njofton AK se punimet mbaruan në datën 4-7-2017, pra 26 ditë përpara afatit të përfundimit të punimeve. Amendament kontrata e bërë nga Bashkia Dropull mban datën 25-04-2017 me nr prot 508/1 dhe ka shtyrë punimet deri në datën 30-07-2017 duke parë të arsyeshme të gjithë faktorët që sollën këtë shtyrje. Bashkëngjitur do të gjeni të gjithë dokumentacionin përkatës.

#### **Opinion i grupit të auditimit:**

Përsa observohet për këtë pikë, sqarojmë si më poshtë:

Nga grupi i auditimit është marrë në konsideratë argumenti i paraqitur në amendament në lidhje me temperaturat e ulëta gjatë periudhës së dimrit. Në lidhje me sa pretendohet për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

vonesat nga shpronësimet, përveç faktit që sheshi ka qenë i lirë kur është marrë në dorëzim nga sipërmarrësi, në ditarin e punimeve nuk rezultoi që të jetë ndërprerë puna asnjë ditë për këtë qëllim. Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Më hollësisht janë trajtuar në ANEKS D/4/3**

#### **E. AUDITIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME.**

##### **Gjetja nr.17 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme.**

**Situata:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në

mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar

**Masa Organizative:** Janë rekomanduar 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, është në proces zbatimi 1 masë.

**Masa shpërblim dëmi:** Janë rekomanduar 8 masa me vlerë 4,988,342 lekë, shumë e cila është kontabilizuar.

Deri me datë 31.06.2019, rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 4,988,342 lekë janë realizuar 3,838,290 lekë, ndërsa shuma 1,150,052 lekë nuk është arkëtuar..

**Nga të cilat:**

-Në proces arkëtimi 2 rekomandime në vlerën 574.363 lekë

-Janë nisur njoftimet për 4 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet 575.689 lekë.

**Kriteri** Shkresa nr.1005/76 datë 20.12.2018, e Kontrollit të Lartë të Shtetit për “Rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme”.

**Impakti** Realizimi jo i plotë i të ardhurave.

**Shkaku** Moszbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi** Kryetari i Bashkisë Dropull të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, si masa shpërblim dëmi dhe masa organizative.

**Afati për zbatim** Menjëherë

Më hollësisht trajtuar në ANEKS E bashkëlidhur.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

#### **A- MASA ORGANIZATIVE:**

**1.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Dropull, për vitin 2019 ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësoin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” (trajtuar më hollësisht në faqen 23-24 dhe Aneks A të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në Manualin e Auditit të Brendshëm dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj nuk është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të lwna nga Njwsia e Auditimit të Brendshëm.  
(trajtuar më hollësisht në faqen 24-26 dhe Aneks A të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1/1 Rekomandimi:** Bashkia Dropull të marrë masa, të dërgojë në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësoin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse, për vitin 2019.

#### **Me mbylljen e bilancit të vitit 2019**

**1/2 Rekomandimi:** Nga Bashkia Dropull të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të kryejë monitorimi e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme nga Njësia e Auditimit të Brendshëm.

#### **Menjëherë**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Dropull, Sektori i Taksave nuk ka gjobitur subjektet të cilat në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Neni 114-Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit, pika 1. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Sektori i Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Dropull, nuk kanë rakorduar ndërmjet tyre duke mos kryer akt-rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012 deri më datën 31.12.2018 dhe mos pasqyrimin e saktë në kontabilitet të tyre për debitorë 5 subjekte të biznesit të vogël dhe 10 biznesit të madh, **në vlerën 839,609 lekë dhe 1242 familje për vlerën gjithsej 6,727,637 lekë** (për taksë toke në vlerën 3,580,762 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 1,110,831lekë, për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, Kreu III, paragrafi “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”  
(trajtuar më hollësisht në faqe 31 -32 dhe Aneks B të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2/1 Rekomandimi:** Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Sektori i Taksave Bashkia Dropull të nxjerre të gjitha njoftimet vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 7,567,246 lekë, si më poshtë:

- Debitorë biznesi i madh në vlerën 839,609 lekë;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

- **Debitorë për taksë token ë vlerën 3,580,762 lekë;**
- Debitorë për për taksë ndërtese në vlerën 1,110,831lekë;
- Debitorë për taksë trualli në vlerën 50,344 lekë;
- Debitorë për tarifa shërbimi në vlerën 1,985,700 lekë.

- Të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

**a-Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive** në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar edhe debitorët e taksave të ish komunave.

**b-Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit,** kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**c-Për subjektet të cilët nuk** kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

**d- Edhe pas njoftimeve zyrtare ne** se Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike), pasi të merren masat administrative apo sekuestro të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

**e- Sektori i Taksave** të evidentojnë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, ku përcaktohet se: Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marri masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (tatimpaguesit familjarë dhe bizneset, në territorin përkatës), të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës,/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

**2/2 Rekomandimi:** Bashkia Dropull, të përgatisë aktmarrëveshjen për pagesën e taksave dhe tarifave nga përdoruesit, së bashku me faturat ujit të pijshëm, nëpërmjet Ujësjiellës sh.a, Dropull, e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5 shkronja ii, nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar

#### **Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “*Studime e projekte*”, në bilancin e vitit 2018 paraqitet në vlerën 6,263,032 lekë, ose rritur për vlerën 2,289,278 lekë. Sipas analizës rezulton se në Bashkinë Dropull në 31.12.2018 llogaria 202 paraqet 18 studime dhe kërkime nga të cilat:

- a. *Gjate vitit 2017 janë shtuar 3 studime me vlerën prej 2,339,280 lekë.*
- b. *Gjatë vitit 2018 janë shtuar 4 studime me vlerën prej 3,394,519 lekë.*

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se 28 studime e projekte në vlerën **11,688,221** lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Dropull. Referuar të dhënave të subjektit, ku të gjithë projektet janë vënë në zbatim, kontabilizimi i këtyre vlerave në llog.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

202 është i gabuar, pasi vlera e këtyre projekteve duhej të paraqitej në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (sipas objekteve), pasi përfaqëson vlerën e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”

*(trajtuar më hollësisht në faqet 34 -34 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e projekte*”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, vlerën 11,688,221 lekë.

#### Me hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2019

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” për vitin 2018 rezultojnë se 3 studime dhe kërkime në vlerën prej 1,882,999 lekë nuk kanë filluar të vihen në zbatim: -*Studim projektim “Ujësjellës Selo – Levinë - Krioner” me vlerë 834,999 lekë;* - *Studim projektim “Amfiteatri Sofratikë” me vlerë 528,000 lekë;* -*Studim projektim plani i mbarështimit të pyjeve me vlerë 520,000 lekë.* Për këto asete që njëzia publike ka përllogaritur norma amortizimi në vlerën prej 282,449 lekë, rezultojnë se, referuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05) përcaktohet qartë se; *(projektet e studimit, kur janë për një aktiv konkret koston e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivitetit, pra amortizohen (shpërndahen) në totalin e shpenzimeve të ndërtimit të aktivitetit (situacioni+studimi+projektimi=kosto e plotë e aktivitetit).* Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit, ndërkohë që objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është i gabuar. Kjo procedurë është bërë në kundërshtim seksionin nr. II të VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”, urdhrit të Ministrit të Financave nr.64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*” dhe standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 në pikën nr.40 i cili citon “*Amortizimi i një aktivi afatgjatë fillon kur ai është i gatshëm për përdorim (pra aktivet në proces nuk amortizohen) dhe vazhdon deri në amortizimin e plotë të vlerës së amortizueshme ose deri sa ai çregjistrohet, del nga përdorimi*”

*(trajtuar më hollësisht në faqet 35 -35 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e projekte*”, në mënyrë që në këtë llogari të mos amortizohen aktivet të cilat rezultojnë në proces dhe nuk janë të përfunduara dhe të merren masa për sistemimin e vlerës së përllogaritur të amortizimit 282,449 lekë duke kredituar amortizimin e akumuluar dhe debituar koston historike.

#### Me hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2019

**5.Gjetje nga auditimi:** Aktivet të cilat janë detajuar me regjistra kontabël (210 “*Toka, troje e terrene*”, 211 “*Pyje, Plantacione dhe Kullota*” 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, 213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*”, 214 “*Instalime teknike, makineri , pajisje e vegla pune*”, 215 “*Mjete transporti*”) nuk përmbushin kriteret e paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhurnuar pas bashkimit të njëzive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto regjistra.

Sektori i financës Bashkia Dropull për asnjë periudhë raportuese objekt auditimi (2017-2018), nuk ka kërkuar dhe bërë rivlerësim të pasurisë, aseteve dhe aktiveve të transferuara me VKM në kuadër të reformës territoriale me çmimin referues, si dhe nuk janë pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në pasqyrat financiare për secilën periudhë raportuese konkretisht:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

**-llog.(210)**“*Toka, troje, terrene*” vlera kontabël 198,582 lekë e pa ndryshuar.

**-llog.(211)**“*Pyje, kullota, plantacione*” vlera kontabël 0 lekë e pa ndryshuar.

Sektori i Financës dhe kontabilitetit për këto asetet nuk disponon regjistra, kartela llogarie dhe dokumentet kontabël me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj.*) në kundërshtim me nenin nr.7 të ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “, dhe sipas pikave nr.73, 97, 99, 100, 102, 105 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “ *Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”

(*trajtuar më hollësisht në faqet 35 -36 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Dropull të merren masa për të azhurnuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative duke plotësuar kërkesat e formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe inventarizim.

Titullari i njësisë publike Bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialist përkatës, për evidentimin e asetëve dhe pasurisë të kaluara me VKM në pronësi të bashkisë, ndërsa nga Sektori i Financës, të merren masa me qëllim të saktësohet gjendja fizike dhe kontabël e llog.(210); llog.(211) me qëllim pajisjen me dokumentet e nevojshme tekniko-ligjore për të regjistruar secilin objekt në ZRPP në pronësi të Bashkisë Dropull, si dhe pasqyrimin me dokumente ligjore të gjendjes së këtyre asetëve.

#### Menjëherë

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga rillogaritja e amortizimit sipas normave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore konstatohet se *Llogaria 215 “Mjete Transporti”* amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 5,557,757 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 6,549,997 lekë, pra janë ngarkuar padrejtësisht **992,240 lekë** duke përdorur normë amortizimi në masën 57% dhe jo 20%.

*Llogaria 218 “Inventar ekonomik”* amortizimin e akumuluar vjetor duhet ta ketë në vlerën 12,634,887 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 14,322,963 lekë duke përdorur normë amortizimi në masën 45% dhe jo 20%, pra janë ngarkuar padrejtësisht **1,668,075 lekë** .

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me *pikën 36 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore*

(*trajtuar më hollësisht në faqet 36 -37 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” duke e debituar në vlerën **992,240** lekë dhe sistemimin e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” duke e debituar në vlerën **1,668,075** lekë, të shkaktuara nga përlllogaritja e amortizimit me norma të gabuara të cilat kanë deformuar vlerën kontabël neto të tyre.

#### Menjëherë

**7.Gjetje nga auditimi:** Aktivet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën 0 lekë. Në Bashkinë Dropull, është organizuar dhe funksionon shoqëria aksionare “Ujësjellës Kanalizime Dropull” sha., e cila sipas ekstraktit historik është një shoqëri e themeluar sipas statusit të miratuar datë 16.02.2018, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me NIPT L82616601E me kapitalin fillestar 5.000.000 lekë, me aksionar të vetëm Bashkia Dropull me kapital 100%.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Dropull në “Ujësjellës Kanalizime Dropull“ sh.a në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2018 në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, me urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje” pika nr.35, (trajtuar më hollësisht në faqen 37-38 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë regjistrimin në kontabilitet të pjesëmarrjes në aksione 100% me vlerë kontabël 5,000,000 lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

#### Me hartimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2019

**8.Gjetje nga auditimi:** Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e Sistemit Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) mbi faturat e likuiduara në periudhën **Janar – Dhjetor 2018**, për llogari të vitit 2017 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2017 paraqiten në vlerën 31,016,897 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 17,113,754 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej **13,903,143** lekë më pak (31,016,897-17,113,754). Bazuar në të dhënat e SIFQ detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2017 në bilanc duhet ti kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej **5,215,750** lekë. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në dt.31.12.2017 janë në vlerën prej **25,801,147** lekë, duhet të ishin paraqitur në bilanc të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila për vitin 2017 është në vlerën 0 lekë, Nga analiza e mësipërme duhet të paraqitej në vlerën **25,801,147** lekë.

Kjo llogari duhet të rakordohet me llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me të njëjtën vlerë 25,801,147 lekë

(trajtuar më hollësisht në faqet 39-40 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Për aktivitetin e vitit 2018,** konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në vlerën **2,030,698** lekë ndërsa llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **0** lekë. Arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave, mungesa e lëvrimin të fondeve dhe bllokimit të fondeve nga Ministria e Financave në fund të periudhës ushtrimore.

Në testet e kryera bazuar tek të dhënat e sistemit “SIFQ” mbi faturat e likuiduara në periudhën Janar – Dhjetor 2018, për llogari të vitit 2018 dhe përpara, u konstatua se detyrimet e prapambetura në datë 31.12.2018 paraqiten në vlerën 3,350,087 lekë kurse në bilanc Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 2,030,698 dhe Llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 0 lekë pra me një diferencë prej **1,319,389** lekë më pak (3,350,087-2,030,698). Bazuar në të dhënat e Sistemit Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) detyrimet që Bashkia Dropull në datën 31.12.2018 në bilanc duhet ti kishte të paraqitura te “Llog.401-408” janë në vlerën prej **2,309,333** lekë. Ndërsa detyrimet e prapambetura për rritjen e AQT në datë 31.12.2018 kanë vlerën prej **1,040,754** lekë, të cilat duhet të ishin paraqitur në bilanc të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”. Kjo llogari paraqitet në bilancin 2018 në vlerën 0 lekë. Nga analiza e mësipërme duhet të paraqitej në vlerën 1,040,754 lekë.

(trajtuar më hollësisht në faqet 39-40 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.**

**8.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të rakordojë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën **3,350,087 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave.

Gjithashtu, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për likuidimin e faturave jashtë kontabilitetit, dhe për çdo rast faturat e pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor të bëhet kontabilizimi i tyre, duke i paraqitur si detyrime në fund të periudhave ushtrimore.

**Menjëherë**

**9.Gjetje nga auditimi:** Teprica e Granteve kapitale të huaja përfaqësojnë grante kapitale dhe kontribute nga qeveri dhe institucione ndërkombëtare për investime. Në formatin 6 të pasqyrave ku përshkruhen Investimet dhe Burimet e Financimit është e paraqitur vlera 1,207,243 në llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”, ku rezulton se nga ana e Bashkisë Dropull mungon dokumentacioni dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit të dhuruar nga transferimet e brendshme apo donatorë të huaj në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”

*(trajtuar më hollësisht në faqet 40 -41 dhe aneks C të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës të Bashkisë Dropull të merren masa për të bërë sistemimin në kontabilitet të vlerës **1,207,243** duke debituar llogaritë e grupit 23 (Investime) të aktiveve afatgjata dhe duke kredituar llog.1069 “Grante të huaja në natyrë”.

**Menjëherë**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nga auditimet e mëparshme, me shkresën e KLSH nr.544/8 datë 05/12/2017, rezultoi se:

Masa Organizative: Janë rekomanduar 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, është në proces zbatimi 1 masë.

Masa shpërblim dëmi: Janë rekomanduar 8 masa me vlerë 4,988,342 lekë, shumë e cila është kontabilizuar.

Deri me datë 31.06.2019, rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 4,988,342 lekë janë realizuar 3,838,290 lekë, ndërsa shuma 1,150,052 lekë nuk është arkëtuar..

**Nga të cilat:**

-Në proces arkëtimi 2 rekomandime në vlerën 574.363 lekë

-Janë nisur njoftimet për 4 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet 575.689 lekë.

*(trajtuar më hollësisht në faqet 54 -55 dhe aneks E të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Dropull të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH dërguar me shkresën nr.544/8 datë 05/12/2017, të KLSH dhe trajtuar më hollësisht në aktverifikimin nr.1, datë 07.08.2019, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, nga auditimet e mëparshme”, e protokolluar në Bashkinë Dropull me nr.1007/11, datë 07.08.2018, trajtuar më hollësisht në ANEKS E, bashkëlidhur.

**Menjëherë**

#### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI :**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,419,505 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, *Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 137,897,895 lekë me TVSH, fituar nga BOE “E... & 4 A...” SHPK Tiranë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,854,605 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: Shtresë çakulli t=15 cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri; Shtresë stabilizanti t=15 cm; Shtresë binderi me zall lavatriçe, 6 cm, me makineri; Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm, me makineri. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1198 prot, datë 20.09.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe sipërmarrësit BOE “E... & 4 A...” SHPK

*(trajtuar më hollësisht në faqet 47 -49 dhe aneks D/4/1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Dropull, të merren masa për kompensimin e vlerës prej **1,854,605 lekë pa TVSH** për volumet e punimeve të pakryera nga BOE “E... & 4 A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1198 prot datë 20.09.2017, me objekt “Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor “Unaza e Pogonit” faza I”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Qendër multi funksionale shërbimesh (sistemim i një godine ekzistuese) për Bashkinë Dropull”, me vlerë të kontratës 85,316,927.31 lekë me TVSH, fituar nga OE “A...” SHPK Tiranë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **617,500 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: Zëri “Transport të materialeve të prishura (mbeturina)”; Zëri “F.V Hekur betoni periodik”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 875/1 prot, datë 26.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe sipërmarrësit OE “A...” SHPK

*(trajtuar më hollësisht në faqet 49-51 dhe aneks D/4/2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Dropull, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **617,500 lekë pa TVSH** nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 875/1 prot datë 26.09.2016, me objekt “Qendër multi funksionale shërbimesh (sistemim i një godine ekzistuese) për Bashkinë Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Ujësullsi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës*”, *Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 68,995,558 lekë, fituar nga OE “A...” SHPK, rezultuan diferenca në





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” TË USHTRUAR NË BASHKINË DROPULL.

volume pune të pakryera në fakt në vlerën 947,400 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1523 prot datë 29.12.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE “A...” SHPK (trajtuar më hollësisht në faqet 51 - 54 dhe aneks D/4/3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **947,400 lekë pa tvsh** nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1523 prot datë 29.12.2016, me objekt “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, Bashkia Dropull, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

#### C. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Dropull t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës**, si më poshtë:

- **50,000 lekë për Z. A.K.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektet “Ujësjellësi i jashtëm i Dropullit nga burimi i Manxifës”, **Bashkia Dropull**, me sipërmarrës punimesh OE “A...” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **947,400 lekë pa tvsh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

#### GRUPI I AUDITIMIT

L.B., Përgjegjës Grupi

D.K., Auditues

A.H., Auditues

A.Z., Kryeauditues

S.M., Auditues

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT